


PËRFAQËSIMI POLITIK NË KËSHILLAT BASHKIAKE PAS ZBATIMIT TË KUOTËS GJINORE **50/50**

ÇFARË PO NDODH ME HENDEKUN GJINOR?



AWEN është një rrjet organizatash, të cilat punojnë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave. Rrjeti ynë përbëhet nga 10 organizata që punojnë së bashku për të fuqizuar vajzat dhe gratë në aspektin social, ekonomik, dhe politik. Rrjeti ynë synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet organizatave për të rritur ndikimin e aktiviteteve të përbashkëta në nivel kombëtar dhe për të fuqizuar lëvizjen feministe në Shqipëri.

“SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” është projekt i cili kontribuon në forcimin e demokracive pjesëmarrëse dhe integritimit euroatlantik në Ballkanin Perëndimor duke fuqizuar organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e OSHC-ve për një rol më të fortë dhe aktiv në krijimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, dhe Serbinë.

Raporti kërkimor “Përfaqësimi politik në këshillat bashkiake pas zbatimit të kuotës gjinore 50/50: Çfarë po ndodh me hendekun gjinor?” është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za Promociju Civilnog Društva (CPCD) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendrën për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM), dhe është mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e raportit kërkimor është përgjegjësi e vetme e AWEN dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

FALENDERIME

Falenderime të veçanta shkojnë për bashkëpunëtorët dhe bashkëpunëtoret e AWEN që grumbulluan të dhëna në këshillat bashkiake. Falë përpjekjeve të tyre, u grumbulluan të dhëna në 11 këshilla bashkiake përgjatë periudhës gusht – dhjetor 2023. U jemi mirënjohëse këshilltarëve dhe këshilltareve që ndanë me ne eksperiencat dhe mendimet e tyre rreth ndryshimeve në përfaqësimin politik. Transkriptimi i mbledhjeve të këshillave bashkiake dhe intervistave—një proces që kërkon shumë durim dhe vëmendje—u realizua nga studente dhe ish-studente të shkencave sociale, të cilat i falenderojmë për punën e palodhur dhe përkushtimin që treguan. Studimi nuk do të ishte realizuar pa mbështetjen e SMART Balkans dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, të cilët i falenderojmë që mundësuan realizimin e projektit.

Autore: **Marsela Dauti**, PhD dhe **Geldona Metaj**, MSW

Prill 2024 | Tiranë, Shqipëri

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA	10
3. GJETJET	12
3.1. PËRFAQËSIMI POLITIK NË KËSHILLAT BASHKIAKE: VËZHGIME NË TERREN	12
3.2. KËSHILLTARËT MARRIN FJALËN	16
3.3. KËSHILLTARËT DISKUTOJNË RRETH CILËSISË SË QEVERISJES	19
3.4. KËSHILLTARËT DISKUTOJNË RRETH SHËRBIMEVE VENDORE	23
3.5. KËSHILLTARËT SHPJEGOJNË NDRYSHIMET NË KOHË	27
4. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME	30
REFERENCAT	33
SHTOJCAT	35

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas gjinisë	16
Figura 2: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas muajit dhe gjinisë	17
Figura 3: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas këshillit bashkiak dhe gjinisë	17
Figura 4: Frekuenca e ndërprerjes së fjalës gjatë diskutimeve	18
Figura 5: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës sipas gjinisë dhe vitit	19
Figura 6: Frekuenca e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes	20
Figura 7: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes—sipas gjinisë	21
Figura 8: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes—sipas vitit	22
Figura 9: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—zbatimi i ligjit dhe transparenca—sipas gjinisë dhe vitit	22
Figura 10: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas shërbimeve	23
Figura 11: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës sipas shërbimeve dhe gjinisë	24
Figura 12: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—shërbimet—sipas vitit	25
Figura 13: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—shërbimet—sipas gjinisë dhe vitit	26

1. HYRJJE

Viti 2015 shënoi një kthesë të rëndësishme për përfaqësimin politik në këshillat bashkiake, të paktën numerikisht. Si rezultat i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor—midis të cilave edhe rritja e kuotës gjinore në 50%—përfaqësimi i grave në këshillat bashkiake pothuajse u trefishua. Në zgjedhjet vendore të vitit 2011, gratë përbënin 30.24% të kandidatëve dhe 12.33% të fituesve.¹ Ndërkohë, në zgjedhjet vendore të vitit 2015, gratë përbënin 49.36% të kandidatëve dhe 34.80% të fituesve.² Përfaqësimi i grave në këshillat bashkiake vazhdoi të rritej. Në zgjedhjet vendore të vitit 2019, gratë përbënin 49.02% të kandidatëve dhe 43.61% të fituesve.³ Ndërsa në zgjedhjet vendore më të fundit—ato të vitit 2023—gratë përbënin 49.8% të kandidatëve.^{4,5}

Shqipëria renditet ndër vendet europiane me përfaqësimin më të lartë të grave në këshillat bashkiake.⁶ Në fakt, në nivel global, përfaqësimi i grave në këshillat bashkiake është më i lartë se në Parlament, 36% kundrejt 27%.⁷ Ndërkohë, përfaqësimi numerik i grave në nivel vendor në vende të tilla si Serbia, Maqedonia e Veriut, dhe Mali i Zi është 38%, 35%, dhe 33%, respektivisht.⁸ Zyrtarët politikë në Shqipëri, veçanërisht ata të partisë në pushtet, nuk hezitojnë ta cilësojnë rritjen numerike të grave në politikë si një arritje të rëndësishme.⁹ Ndodh shumë shpesh, siç na ndodhi edhe ne gjatë studimit, që kur nis diskutimi i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiake, ai pasohet me shembuj nga qeveria, Parlamenti, apo edhe organizatat bazë të Partisë Socialiste që supozohet të bashkë-drejtohen nga një burrë dhe një grua. Këto lloj diskutimesh, të cilat nuk kufizohen vetëm tek Partia Socialiste, në dukje, nxjerrin në pah rëndësinë që i kushtojnë partitë politike përfshirjes së grave në politikë. Diskutimet bëhen në frymën e modernizimit dhe demokratizimit të partive politike.

Rritja e prezencës së grave në këshillat bashkiake në vitin 2015 u pa me skepticizëm nga disa grupe. Një nga shqetësimet ishte se rritja e prezencës së grave në këshillat bashkiake do të përdorej nga drejtuesit politikë për të forcuar pushtetin e tyre. Ky shqetësim, në fakt, është global. Një numër autorësh



- 1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 2011. "Zgjedhjet Vendore 2011: Të Dhëna për Numrin e Njësive Vendore ku është Shkelur Kriteri Gjinor në Paraqitjen e Listave Shumëmëmore për Këshill nga Partitë Politike." Tiranë, Shqipëri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- 2 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 2015. "Të Dhëna mbi Kuotën Gjinore për Kandidimet në Zgjedhjet Vendore 2015." Marrë nga: http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/kuota_gjinore_kandidimet_Zgjedhjet_%20Vendore_%202015.pdf.
- 3 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 2019. "Zgjedhjet vendore 2019 – Tabela Përmbledhëse." Marrë nga <https://cec.org.al/wp-content/uploads/2020/02/2019-Tabela-Permbledhese-Final-1.pdf>
- 4 OSBE [Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut]. 2023. "Zgjedhjet Vendore 14 Maj, 2023: Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve." Varshavë.
- 5 Përmbledhja e rezultateve të zgjedhjeve vendore—të mbajtura në vitin 2023—nuk është vendosur ende në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 6 Council of European Municipalities and Regions. 2019. "Women in Politics: Local and European Trends." Marrë nga: https://www.iknowpolitics.org/sites/default/files/cemr_study_women_in_politics_en.pdf.
- 7 Berevoescu, Ionica, and Julie Ballington. 2021. "Women's Representation in Local Government: A Global Analysis." New York, NY: UN Women.
- 8 UN Women. 2024. "Women in Local Government." Marrë nga: <https://localgov.unwomen.org/>
- 9 Si gjatë prezantimit të gjetjeve të studimit Matja e Demokracisë së Brendshme të Partive Politike në Shqipëri të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (22 Nëntor, 2022) ku një përfaqësuese e partisë më të madhe në vend tha plot krenari se organizatat politike në bazë kanë arritur barazi të plotë pasi bashkëdrejtohen nga një burrë dhe grua. Ose gjatë vizitës të Kryeministrit në Elbasan, shih <https://ata.gov.al/2023/04/27/rama-grate-dhe-vajzat-socialiste-kane-vendin-dhe-zerin-e-tyre-sot/>

argumentojnë se pas refrenit të drejtuesve politikë dhe zellit që ata tregojnë ndaj përfaqësimit numerik të grave në politikë qëndrojnë qëllime strategjike. Liderët autokratë përdorin rritjen numerike të grave në politikë që të përmirësojnë reputacionin në arenën ndërkombëtare, të legjitimojnë pushtetin në sytë e publikut dhe të organizatave të shoqërisë civile, apo të zhvendosin vëmendjen nga krizat politike apo ekonomike—strategji këto që i ndihmojnë të qëndrojnë më gjatë në pushtet. Kështu, reformat e barazisë gjinore transformohen në një instrument manipulues që edhe pse duket sikur nxisin qeverisjen e mirë, në realitet e dobësojnë atë.¹⁰

Në vitin 2016—një vit pas zbatimit të kuotës gjinore 50/50 në këshillat bashkiake—ne ndoqëm dhe analizuam mbledhjet e 11 këshillave, të realizuara gjatë periudhës gusht – dhjetor 2016.¹¹ Për të parë ndryshimin në kohë, u rikthyem në të njëjtat këshilla bashkiake në vitin 2018. Përsëri, ndoqëm dhe analizuam mbledhjet e realizuara gjatë periudhës gusht – dhjetor 2018.¹² Analizimi i mbledhjeve nxorri në pah se diskutimet mbizotëroheshin nga burrat. Një tjetër gjetje ishte se gjatë llogaridhënies së zyrtarëve të Bashkisë, gratë, krahasuar me burrat, ishin më të shqetësuara për mungesën e transparencës dhe e merrnin fjalën më shpesh për të kërkuar transparencë.¹³ Megjithatë, kanë kaluar disa vite nga raundi i dytë i grumbullimit të të dhënave. Si ka ndryshuar përfaqësimi politik në këshillat bashkiake? Një pritshmëri është që gratë e kanë intensifikuar pjesëmarrjen e tyre në diskutime. Gratë kanë fituar më shumë eksperiencë në këshillat bashkiake dhe e kanë përkthyer eksperiencën në më shumë angazhim. Po ashtu, është thyer stereotipi se këshillat bashkiake janë hapësira politike ku marrin pjesë vetëm burrat. Rritja e prezencës së grave në këshillat bashkiake do të ndikojë edhe burrat, duke i bërë ata më pranues të rolit dhe rëndësisë së grave në vendimmarrjen politike vendore. Një tjetër pritshmëri është që kontributi i grave do të ndihet veçanërisht në fushën e mirëqenies sociale. Kjo për arsye se bashkëpunimet mes këshilltareve, siç janë aleancat e këshilltareve, të mbështetura nga komuniteti ndërkombëtar, kanë theksuar realizimin e aktiviteteve që lidhen me mirëqenien sociale. Aleancat e Grave Këshilltare, për shembull, kanë ndër marrë nisma që fokusohen tek gratë sipërmarrëse, gratë në situatë të vështirë ekonomike dhe sociale, gratë në zonat rurale, viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuara, dhe gratë kryefamiljare.¹⁴

Megjithatë, ka edhe arsye pse këto pritshmëri mund të mos qëndrojnë. Dobësimi i demokracisë së brendshme të partive apo centralizimi i pushtetit politik¹⁵ do të reflektohet në këshillat bashkiake. Një nga mënyrat sesi zhvillimet politike në nivel qendror mund të ndikojnë tek këshillat bashkiake është që—nën presionin e drejtuesve politikë—këshilltarët të ndjekin vetëm axhendën e partisë politike. Nëse do të jetë ky rasti, atëherë ndryshimet midis grave dhe burrave në këshillat bashkiake nuk do të jenë



- 10 Bjarnegard, Elin, and Pär Zetterberg. 2022. "How Autocrats Weaponize Women's Rights." *Journal of Democracy* 22 (2): 60–75; Bjarnegård, Elin, and Daniela Donno. 2023. "Window-Dressing or Window of Opportunity? Assessing the Advancement of Gender Equality in Autocracies." *Politics & Gender*, 20 (1): 229–234; Bush, Sarah Sunn, and Pär Zetterberg. 2021. "Gender Quotas and International Reputation." *American Journal of Political Science* 65 (2): 326–41; Donno, Daniela, Sara Fox, and Joshua Kaasik. 2022. "International Incentives for Women's Rights in Dictatorships." *Comparative Political Studies* 55 (3): 451–92; Valdini, Melody Ellis. 2019. *The Inclusion Calculation: Why Men Appropriate Women's Representation*. New York, NY: Oxford University Press.
- 11 Në total, 37 mbledhje. Studimi i realizuar në vitin 2016 u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Shih Dauti, Marsela, & Geldona Metaj. 2017. *Gender Quotas and Women's Substantive Representation in the Local Councils of Albania*. Tirana, Albania: United Nations Development Programme.
- 12 Në total, 38 mbledhje të këshillave bashkiake. Studimi i realizuar në vitin 2018 u mbështet nga Programi Horizont 2020 (H2020 Marie Skłodowska-Curie Actions).
- 13 Dauti, Marsela. 2021. "'The Newcomer Effect': Gender Quotas, State Reforms and Service Responsiveness in Local Councils." *International Journal of Social Welfare* 30 (3): 330–41; Dauti, Marsela. 2022. "Bystanders or Contesters? Women's Political Representation and Quality of Government in the Local Councils of Albania." *Journal of Women, Politics & Policy* 44 (3): 274–98.
- 14 Bashki të Forta. 2019. "Aleancat e Grave në Këshillat Bashkiakë 2015-2019: Praktikat më të Mira." Tiranë, Shqipëri: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.
- 15 Xhaferaj, Anjeza. 2022. "Matja e Demokracisë së Brendshme të Partive Politike në Shqipëri." Tiranë, Shqipëri: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

të mëdha. Një tjetër pritshtëri, bazuar në studimet më të fundit, është që rritja e prezencës së grave në këshillat bashkiake do të “aktivizojë”¹⁶ më shumë empati dhe konsideratë nga burrat për fushat që, tradicionalisht, janë konsideruar si fusha që u përkasin grave, siç është arsimit dhe mirëqenia sociale. Por, ky mekanizëm mund të funksionojë edhe në kahun tjetër: Gratë mund të zhvillojnë më shumë konsideratë për fushat që, tradicionalisht, janë konsideruar si fusha që u përkasin burrave, siç është infrastruktura rrugore. Si rezultat, gradualisht, hendeku gjinor do të ngushtohet.

Për të shqyrtuar sesi ka ndryshuar përfaqësimi politik në këshillat bashkiake në kohë, ne u rikthyem në të njëjtat këshilla bashkiake, tanimë për herë të tretë. Në mënyrë të ngjashme me vitin 2016 dhe vitin 2018, u grumbulluan të dhëna gjatë mbledhjeve të këshillave bashkiake—një metodë që lejon përdorimin e të dhënave që mbështeten në sjelljen e vëzhguar, jo në sjelljen e raportuar. Përveç kësaj, u realizuan intervista me një grup këshilltarësh për të kuptuar natyrën dhe arsyet e ndryshimeve në kohë. Rezultatet pasqyrojnë një situatë shumë të ndryshme nga ai i refrenit të partive politike. Ndërkohë që përfaqësimi numerik i grave është rritur, hendeku gjinor brenda këshillave bashkiake është thelluar. Intervistat me këshilltarët ofrojnë disa shpjegime për ndryshimet e vëzhguara.

Pjesa në vazhdim e raportit ndahet si më poshtë: Seksioni 2 përshkruan metodologjinë e studimit. Seksioni 3 prezanton gjetjet, të cilat si fillim ndalen në dinamikat që kemi vëzhguar brenda këshillave bashkiake, marrjen e fjalës, dhe diskutimet rreth cilësisë së qeverisjes dhe shërbimeve vendore. Seksioni 4 paraqet shpjegimet që japin këshilltarët rreth ndryshimeve që kanë ndodhur në kohë. Shtojcat paraqesin të dhëna shtesë në lidhje me analizimin e të dhënave, rezultatet e analizës statistikore, dhe karakteristikat e pjesëmarrësve në studim.



16 Wängnerud, Lena. 2022. “Why Women in Elected Assemblies Reduce Levels of Corruption: The Indirect Approach.” *Etica Pubblica. Studi su legalità e partecipazione* 1: 13-28, fq. 23.

2. METODOLOGJIA

Studimi mbështetet në kombinimin e disa metodave. Grupi i punës ndoqi—dhe më tej transkripto—diskutimet e mbledhjeve të këshillave bashkiake, të realizuara gjatë periudhës gusht – dhjetor 2023. Në total, u transkriptuan 49 mbledhje (1,480 faqe). (Shtojca A, Tabela A1 paraqet të dhëna për mbledhjet e transkriptuara sipas këshillave bashkiake.) Të dhëna u grumbulluan edhe rreth banorëve që ndoqën mbledhjet e këshillave bashkiake për të parë nëse banorët e shohin këshillin bashkiak si një hapësirë ku mund të adresojnë shqetësimet e tyre. Një tjetër metodë që u përdor ishte realizimi i intervistave me këshilltarët. Qëllimi i intervistave ishte të njiheshim me eksperiencat e këshilltarëve si dhe të identifikonim mekanizma që mund të shpjegojnë ndryshimet që kanë ndodhur në këshillat bashkiake në kohë. Për këtë arsye, realizuam intervista me 20 këshilltarë (shkalla e përgjigjes: 40%). Si fillim, synuam të intervistonim këshilltarë që kishin shërbyer më shumë se 1 mandat në këshillin bashkiak. Kjo do të na ndihmonte të kuptonim më mirë këndvështrimet e tyre rreth ndryshimeve në kohë. Megjithatë, duke qenë se shkalla e përgjigjes ishte e ulët, e zgjeruam kampionin duke përfshirë këshilltarët që kishin shërbyer për një mandat. Në këto raste, synuam të përfshinim këshilltarë që—edhe pse po shërbenin në mandatin e parë në këshillin bashkiak—kishin eksperiencë në politikë. Për shembull, kishin qenë anëtarë partie për një kohë relativisht të gjatë apo në të kaluarën kishin patur pozicione të tilla si kryetar/e apo sekretar/e e këshillit bashkiak. (Shtojca F paraqet të dhëna rreth karakteristikave të këshilltarëve, të cilët iu përgjigjën ftesës për t'u intervistuar.) Intervistat u realizuan gjatë periudhës shkurt – prill 2024 përmes platformës Zoom (n = 18) dhe telefonit (n = 2). Intervistat u regjistruan dhe u transkriptuan fjalë për fjalë. Një prej pjesëmarrësve në studim nuk pranoi që intervista të regjistrohej.

Në terren punuan 11 persona (10 gra, 1 burrë)—anëtarë apo bashkëpunëtorë të AWEN—të cilët ndoqën dhe grumbulluan të dhëna gjatë mbledhjeve të këshillave bashkiake. I njëjti numër u përfshi edhe në transkriptimin e mbledhjeve të këshillave bashkiake. Transkriptueset ishin studente dhe ish-studente të shkencave sociale.

Pjesa më e madhe e takimeve, 32 nga 49 (65%), u dha online dhe mund të ndiqej në faqen e këshillave bashkiake në Facebook. Dhënia e takimeve online solli disa avantazhe për grupin e punës, veçanërisht për personat që u morën me transkriptimin e takimeve. Krahasuar me vitet e mëparshme, takimet mund të ndiqeshin më lehtë si dhe të kuptoheshin më mirë ndërveprimet mes këshilltarëve si dhe dinamikat gjatë takimeve. Megjithatë, mbledhjet online sollën probleme të reja. Së pari, kishte disa raste kur këshilltarët nuk dëgjoheshin nga fillimi e deri në fund të mbledhjes. Së dyti, mikrofonat nuk punonin gjithmonë apo kishte një numër shumë të vogël, të pamjaftueshëm për t'u përdorur nga të gjithë këshilltarët. Së treti, në dy raste mbledhjet qëndruan vetëm pak ditë në faqen e këshillit bashkiak në Facebook. Së katërti, ndjekja e mbledhjeve bëhej shumë e vështirë pasi, përveç zërit të paqartë, kishte zhurma të tjera, si hapja dhe mbyllja e derës apo biseda në sfond. Për këto arsye, në 6 raste grupi i transkriptuesve iu referua dy burimeve në të njëjtën kohë—mbledhjes të transmetuar online si dhe regjistrimit të mbledhjes të realizuar nga grupi në terren.

Gjatë grumbullimit dhe analizimit të të dhënave vumë re disa praktika. Në disa raste, shkëputja e zërit—gjatë mbledhjeve të dhëna online—ndodhte kur tensionohej situata. Për shembull, këshilltari dhe kryetarja e këshillit debatonin ashpër, këshilltari akuzonte Kryetarin e Bashkisë për abuzim me fondet, apo një banor denonconte Bashkinë për tjetërsim të pronës. Në këto raste dukej se ndërprerjet e zërit, të cilat nuk zgjasnin shumë, ishin të qëllimta. Një tjetër praktikë ishte mbyllja e mikrofonit të këshilltarëve. Kjo ndodhi në momentin kur një prej këshilltarëve po kritikonte Kryetarin e Bashkisë. Në një prej Bashkive më të mëdha në vend, online u dha vetëm hapja dhe mbyllja e mbledhjes. Pavarësisht se mbledhja zgjati disa orë, shikuesit mund të ndiqnin vetëm rreth 5 minuta. Mbledhjet online, në dukje, mund të krijojnë përshtypjen se ka transparencë, por në fakt taktikat që përdoren sugjerojnë se censura është prezente.

Dhënia e mbledhjeve online u përdor edhe si pretekst për moslejimin e grupit të punës të ndiqte takimet drejtpërdrejtë apo të regjistronte takimet. Kjo pengesë u has në dy këshilla bashkiake. Edhe pse u shpjegua se regjistrimi apo ndjekja e takimeve fizikisht ishte e rëndësishme pasi do të grumbullohej informacion edhe rreth banorëve që ndiqnin takimet e këshillave, ato nuk u lejuan. Këto ishin edhe këshillat ku vumë re nivele të larta të kontrollit të diskutimeve apo censurës.

Për analizimin e të dhënave u përdorën disa metoda. Analizimi i transkriptimeve të takimeve nisi me identifikimin e fjalëve kyçe, të cilat u përdorën gjatë përpunimit të gjuhës natyrore (ang: natural language processing). Fjalët kyçe u identifikuan gjatë leximit të transkriptimeve. (Shih Shtojcën E për listën e fjalëve kyçe të përdorura.) Rezultatet u eksportuan në Excel dhe më tej u përdorën në programin statistikor Stata 12.1 për të përshkruar të dhënat dhe për të bërë krahasime sipas temave, gjinisë, dhe vitit. Analizimi i të dhënave është i ngjashëm me atë të realizuar në vitin 2016 dhe vitin 2018. Ndërsa analizimi i transkriptimeve të intervistave u mbështet në analizën tematike. Secila intervistë e transkriptuar u analizua në bazë të pyetjeve të drejtuara dhe temave të zhvilluara paraprakisht. Analiza u fokusua veçanërisht në mënyrën sesi këshilltarët i shpjegojnë ndryshimet në kohë dhe mekanizmat e ndryshimit që propozojnë.

3. GJETJET

3.1. PËRFAQËSIMI POLITIK NË KËSHILLAT BASHKIAKE: VËZHGIME NË TERREN

Më poshtë kemi renditur dhe përshkruar problemet e vëzhguara gjatë mbledhjeve të këshillave bashkiake. Qëllimi ynë nuk është të përgjithësojmë problemet për të gjitha këshillat bashkiake. Megjithatë, ka raste kur një problem—apo kombinim problemesh—haset në më shumë se një këshill.

LLOGARIDHËNIA E ADMINISTRATËS NË NIVELE TË ULTA

Këshilltarët pritet të vendosin stafin e bashkisë para përgjegjesisë dhe të kërkojnë llogari për fushat që mbulon stafi. Në shumë prej mbledhjeve që vëzhguam, llogaridhënia ishte në nivele të ulta. Këshilltarët kërkonin pak sqarime apo nuk thelloheshin me pyetjet e tyre. Por, edhe kur këshilltarët ishin shumë të angazhuar dhe bënë pyetje, stafi i Bashkisë jepte përgjigje të shkurtra ose nuk jepte përgjigje fare. Projekt-vendimet kalonin shumë shpejt. Për ironi, në disa raste drejtuesit e Bashkisë—apo stafi—i kërkonte llogari këshilltarëve se përse po kërkonin llogari! Për shembull, në një prej takimeve, Kryetarja e Bashkisë u kërkoi llogari këshilltarëve se përse bënë pyetje rreth projek-vendimeve dhe nuk i votonin menjëherë. Në një tjetër takim, kërkesës së këshilltares për transparencë rreth përdorimit të burimeve natyrore, Kryetari i Bashkisë iu përgjigj duke thënë se kërkesa nuk kishte kuptim. Në vazhdim, ai i kërkoi llogari këshilltarëve se përse po vinin në dyshim punën e Bashkisë dhe të qeverisë qendrore.

PRAKTIKA AUTOKRATIKE

Gjatë analizimit të mbledhjeve vëzhguam praktika që na shqetësuan së tepërmi. Konkretisht, këshilltarët e partisë në pushtet iu kërkonin këshilltarëve të opozitës të mos ngrinin pyetje në këshill, por t'i kërkonin përgjigjet vetë në zyrat e Bashkisë; sulmuan një organizatë jo-qeveritare për të dëmtuar reputacionin dhe besueshmërinë e organizatës tek publiku; si dhe iu kundërpërgjigjën kritikave ndaj Bashkisë me falenderime drejtuar Kryetarëve të Bashkisë apo qeverisë qendrore. Po ashtu, këshilltarët e partisë në pushtet jo rrallë vepronin si staf Bashkie. Ata/ato merrnin fjalën dhe jepnin shpjegime rreth drejtorive të Bashkive apo kritikonin këshilltarët që bënë pyetje. Në plot raste, kjo tendencë u vu re edhe tek Kryetarët e këshillave bashkiake, të cilët ndërhyjnë në diskutime për të justifikuar veprimet e stafit të Bashkisë apo t'iu kthenin përgjigje këshilltarëve rreth performancës së Bashkisë. Gjatë vëzhgimeve, u shqetësua për tonin e ashpër të Kryetarëve të Këshillave, përfshi këtu edhe ndërprerje të fjalës të këshilltarëve, ofendime, apo batuta. Për shembull, në një prej takimeve Kryetarja e Këshillit nuk ia jepte fjalën këshilltarëve që kishin kritika ndaj Kryetarit të Bashkisë. Apo, iu përgjigj kritikave të këshilltarëve ndaj dëgjësave publike duke thënë se Bashkia ka bërë konsultime me disa grupe interesi. Por kishte edhe praktika të tjera, si ndërprerja e audios, mbyllja e mikrofonit të këshilltarëve, apo moslejimi i banorëve të ndiqnin mbledhjet.

Në disa mbledhje, diskutimet u dominuan nga drejtuesit e Bashkisë; drejtuesit e këshillave qëndronin në hije. Për shembull, në një prej takimeve, Kryetarja e Bashkisë luajti rolin e Kryetarit të këshillit bashkiak. Ajo drejtoi takimin, u kërkoi këshilltarëve të votonin, ndërpriste këshilltarët dhe kishte ton imponues gjatë të gjithë takimit.

Një praktikë e përhapur veçanërisht në Bashkitë e mëdha ishte dhënia e fjalës vetëm një herë për një çështje të rendit të ditës. Këshilltarët mund të ngrinin shqetësime, por e merrnin fjalën vetëm një herë. Ndërkohë, drejtuesit e Bashkisë grumbullonin pyetjet dhe jepnin përgjigjet në fund. Ajo çfarë ne vëzhguam ishte se ky rregull e formalizonte diskutimin dhe shmangte llogaridhënien. Përgjigjet e administratës ishin të përgjithshme dhe vazhdohej me aprovimin e projektvendimeve.

Këshilltarët e opozitës nuk hezituan ta cilësonin këshillin si “shtojcë” të Bashkisë, “zyrë noteriale,” apo kryetarët e këshillave si “zëdhënës” të Kryetarëve të Bashkisë.

KËSHILLTARËT KËRKOJNË PËRGJIGJE, POR DELEGOHEN TEK QEVERIA QENDRORE

Delegimi ndodhte sidomos kur këshilltarët kishin pyetje rreth investimeve publike, si investimet në infrastrukturën rrugore, apo ndërhyrjet e kompanive private në territorin e Bashkisë. Edhe pse këshilltarët sillnin problemet e banorëve—për shembull, diskutonin se si kompanitë private kishin prishur rrugët gjatë ndërhyrjeve në komunitet, punimet kishin cilësi të dobët, apo transparencë rreth investimeve në infrastrukturën rrugore mungonte—problemët nuk adresoheshin. Përgjigjia, si në një prej rasteve, ishte që këshilltarët t'i drejtoheshin Ministrisë dhe jo Bashkisë. Kërkesat për transparencë në lidhje me rregullimin e rrugëve në qytet—vlerën e investimit, afatin e përfundimit, dhe kompaninë përgjegjëse—në një prej këshillave, morën përgjigjen që këshilltarët duhet të jenë falenderues për investimet e qeverisë qendrore dhe të mos ngadalësojnë procedurat duke kërkuar transparencë.

KËSHILLTARËT KËRKOJNË ADRESIMIN E PROBLEMEVE NË QEVERINË QENDRORE, POR DEKURAJOHEN NGA DREJTUESIT APO ADMINISTRATA E BASHKISË

Në një prej këshillave u diskutuan problemët që hasin personat me aftësi të kufizuara, ndër të cilat edhe udhëtimi në distanca të largëta për të plotësuar dokumentacionin. Një këshilltare kërkoi që shqetësimet të adresohen—nga këshilli dhe administrata e Bashkisë—në qeverinë qendrore përmes një peticioni. Megjithatë, ky propozim nuk u mirëprit. Në një tjetër rast, një prej këshilltareve ngriti problemin e mungesës së ilaçeve për personat që vuajnë nga kanceri. Ajo shpjegoi se ilaçi është në dispozicion vetëm në Tiranë, ndërkohë që mund të ofrohej edhe në vende të tjera. Kur kjo këshilltare e ngriti problemin, Kryetari i Bashkisë tha “S’ka lidhje Bashkia.” Ndërkohë, ndërhyri Kryetarja e Këshillit duke thënë se duhet t’i bëhet propozim qeverisë qendrore për më shumë fonde. Më tej, Kryetari i Bashkisë sugjeroi që këshilli t’i dërgojë një shkresë qeverisë qendrore.

MATERIALET NUK SHPËRNDAHEN NË KOHË DHE NË MËNYRA TË NDRYSHME (P.SH., PËRMES POSTËS), NË VARËSI TË NEVOJAVE TË KËSHILLTARËVE

Këshilltarët diskutuan se nuk njoftohen në kohë për mbledhjet e komisioneve dhe të këshillit, nuk marrin materialet në kohë, apo marrin materiale vetëm disa orë përpara mbledhjes. Ky ishte një shqetësim i madh sidomos për këshilltarët që jetonin në zonat rurale.

KËSHILLTARËT JANË TË PAKËNAQUR ME ADMINISTRATËN E BASHKISË DHE RAPORTIMET GJATË MBLEDHJEVE TË KËSHILLAVE BASHKIAKE.

Gjatë takimeve, këshilltarët bëjnë pyetje dhe nuk marrin përgjigje, i ribëjnë pyetjet në disa takime dhe prapë nuk marrin përgjigje, apo bëjnë kërkesa më shkrim dhe nuk marrin përgjigje. Të njëjtat probleme sillen takim pas takimi dhe situata duket se nuk ndryshon. Një problem i shprehur në një numër të madh takimesh ishte që stafi i Bashkisë, veçanërisht drejtuesit/et e drejtorive, nuk janë prezentë gjatë mbledhjeve. Mosprezenca e stafit nuk i lejonte këshilltarët të merrnin informacion rreth temave që diskutoheshin.

Një tjetër problem është që shpjegimet e stafit të Bashkisë janë të vakta. Për shembull, projekt-buxheti nuk jepet me shpjegime të detajuara, tabelat janë të paqarta dhe evidencat janë të pakta. Këshilltarët ankohen për mungesën e transparencës rreth projektvendimeve të propozuara dhe kërkojnë shifra e analiza të situatës. “Po flasim me veten,” tha një nga këshilltarët, për të vënë në pah se administrata e

Bashkisë nuk shkon në mbledhjet e këshillave bashkiake. Këshilltarët, kryesisht të opozitës, kërkuar transparencë dhe kërkesat e tyre sugjerojnë se kanë dyshime rreth asaj çfarë raportohet në mbledhje.

PROBLEME TË THELLA ME DËGJESAT PUBLIKE

Problemet fillonin që me organizimin e dëgjesave publike. Këshilltarët ngritën shqetësimin se njoftimet bëhen vetëm në faqen e internetit të Bashkisë. Informacioni nuk shpërndahet në median lokale apo mjediset që frekuentohen nga një numër i madh i popullsisë, në mënyrë që të shpërndahet informacioni në mënyrë masive.

Realizimi i dëgjesave publike dukej të ishte i rëndësishëm për pjesën më të madhe të Bashkive, sidomos gjatë hartimit të buxhetit. Për shembull, Kryetarja e njëres prej Bashkive tha se gjatë hartimit të buxhetit u organizuan 18 dëgjesa publike, ku morën pjesë 420 persona. Megjithatë, diskutimet e dëgjesave nxorrën në pah disa probleme. Këshilltarët ishin të paqartë se çfarë ishte diskutuar gjatë dëgjesave dhe sesi ishte përdorur informacioni gjatë hartimit të buxhetit. Një prej Kryetarëve të Bashkisë—pasi shpjegoi se u bënë dëgjesa publike në të gjitha njësitë administrative—tha se plani i investimeve për vitin në vazhdim është i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Nga ky shpjegim, nuk ishte e qartë se si kishin shërbyer dëgjesat.

Në një prej takimeve, disa këshilltarë nxorrën në pah problemin se Bashkia kishte organizuar dëgjesa publike për paketën fiskale, por nuk i kishte informuar banorët rreth planit që kishte—rritjen e tarifave. Gjatë dëgjesës ishte bërë një prezantim i përgjithshëm. Për më tepër, stafi i Bashkisë nuk kishte mbajtur shënime. Këshilltarët, në disa prej mbledhjeve, kërkonin procesverbalet e dëgjesave apo materialet ku evidentoheshin kërkesat e banorëve, por ato nuk viheshin në dispozicion. Në disa mbledhje, këshilltarët shprehën shqetësimin se stafi i Bashkisë bën më shumë përpjekje për të promovuar dëgjesat në median sociale sesa në organizimin e mirë të dëgjesave. Këshilltarët e opozitës i cilësuan konsultimet si “farsë,” “false,” “pseudokonsultime,” apo “konsultime fallco.”

SHUMË PAK EKSPERTIZË E PAVARUR GJATË MBLEDHJEVE

Këshillat bashkiake nuk janë hapësira ku dëgjohet ekspertiza e pavarur. Shpjegimet rreth projektvendimeve të propozuara shpesh i bënin drejtuesit/et e Bashkisë, të cilët priren të fokusohen tek arritjet dhe të anashkalojnë problemet. Vetëm në një prej takimeve ishte ftuar një specialist i pavarur, inxhinier, i cili dha mendimin e tij rreth sigurimit të ujit të pijshëm në territorin e Bashkisë.

KRIKUA NDAJ PROGRAMEVE SOCIALE

Projektvendimet që fokusohen në zgjerimin e programeve apo shërbimeve sociale, zakonisht, nuk kontestohen. Këshilltarët priren t'i mbështesin familjet në nevojë. Megjithatë, dy programe—programi i ndihmës ekonomike dhe programi i strehimit social—marrin kritika të vazhdueshme me argumentin se përfitimet shpërndahen në mënyrë të padrejtë dhe shërbejnë, siç tha një këshilltar, si “qokë politike,” sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Konkretisht, programi i ndihmës ekonomike u kritikua nga një numër i madh këshilltarësh të opozitës, të cilët argumentuan se programi përdoret për të shpërblyer “patronazhistët” gjatë fushatës zgjedhore. Po ashtu, këshilltarët iu referuan rasteve në komunitet—persona që zotëronin asete dhe pasuri të paluajtshme dhe që kishin fituar në mënyrë të padrejtë nga programi i strehimit social, apo persona që kishin përfituar kredi të butë e jepnin banesën e tyre me qira. Për të dyja programet, një numër këshilltarësh kërkuar “pastrim të listave,” edhe duke i komunikuar administratës se listat do t'i raportohen “krimit ekonomik” apo SPAK-ut.

Një numër këshilltarësh ndanë shqetësimin se aplikimet online—përmes e-Albania—kanë rritur kostot për personat që kanë nevojë për shërbime. Përdorimi i platformës është i vështirë dhe personave

në nevojë u duhet të drejtohen tek shërbimi privat, duke e bërë procesin të kushtueshëm. Mbyllja e sporteve, po ashtu, ka eliminuar mundësinë që banorët të drejtojnë pyetje apo të kërkojnë ndihmë. Këshilltarët kërkuan që administrata e Bashkisë të jetë më e ndjeshme ndaj këtyre rasteve dhe të ofrojë shërbim ballë-për-ballë, siç është në rastet kur aplikohet për strehim social.

Vëmendja e këshilltarëve ndaj programeve që mbështesin moshën e tretë duket të jetë rritur. Këshilltarët bënë propozime për zgjerimin e shërbimeve, prezantuan nisma të reja—si krijimin e një qendre ditore për të moshuarit—si dhe i dhanë mbështetje të plotë projekteve që financoheshin nga donatorë, si ofrimin e shërbimit në shtëpi për të moshuarit e vetmuar.

NJË NUMËR SHUMË I VOGËL I BANORËVE MARRIN FJALËN

Numri i banorëve që e morën fjalën në mbledhjet e vëzhguara ishte 5. Një banor tentoi ta merrte fjalën, por nuk u lejua. Kryetari i këshillit i kërkoi të dilte jashtë, duke i thënë se mund ta ndjekë mbledhjen online. Banori u largua. Banorët që morën fjalën kërkuan vlerësim të drejtë të dëmeve të bëra në banesë për shkak të rënies së zjarrit, mbështetje financiare për kryerjen e ndërhyrjes mjekësore tek fëmijë me aftësi të kufizuara, informacion për rindërtim pallati të prishur nga tërmeti, dhe strehim social.

Edhe në rastet kur banorët e morën fjalën, eksperiencia nuk ishte aspak e mirë. Në një prej mbledhjeve ku banorja kërkoi të merrte fjalën—pasi lidhej me temën që po diskutohej—Kryetarja e këshillit nuk e lejoi, duke i thënë se mund ta marrë fjalën vetëm në fund të mbledhjes, dhe iu drejtua banores me tone të ashpra. Për më tepër, kur banorja e mori fjalën, regjistrimi u ndërpre. Një tjetër problem që vumë re është që edhe kur banorët e morën fjalën, nuk u lejuan ta prezantonin rastin e tyre plotësisht. Duket se dhënia e fjalës ishte vetëm për procedurë. Për shembull, në një prej takimeve, banorja, e cila u ndërpre disa herë gjatë marrjes së fjalës, iu drejtua Kryetares së këshillit duke i thënë “më ler të shprehem.” Kryetarja e këshillit ju përgjigj duke i thënë se “ne e dimë shqetësimin tuaj.”

NJË NUMËR SHUMË I VOGËL I PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE MARRIN FJALËN


Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile e morën fjalën në tri mbledhje. Në të trija rastet përfaqësuesit bënë prezantime me qëllim informimin e këshilltarëve. Prezantimet u fokusuan si më poshtë: prezantimi i vullnetarit të Korpusit të Paqes, diskutimi i rëndësisë së energjisë së rinovueshme në territorin e Bashkisë, dhe informimi i këshilltarëve rreth 15 ditëve të aktivizimit me në fokus dhunën me bazë gjinore. Në rastin e tretë, përfaqësuesja foli për rastet e dhunës, rëndësinë e rritjes së buxhetit për adresimin e rasteve, dhe u kërkoi këshilltarëve të ishin aktivë në median sociale për të ndarë informacion rreth rasteve, si dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Aleancën e Këshilltarëve. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile u fokusuan kryesisht tek informimi i këshilltarëve. Pas prezantimeve të shkurtra, këshilltarët vazhduan me mbledhjen ose e mbyllën atë. Në një rast, Kryetarja e këshillit lexoi një kërkesë të ardhur nga një organizatë lokale ku kërkohet bashkëpunim për zhvillimin e një takimi të rinjve me këshilltarët, për të dhënë informacion rreth mënyrës si funksionon këshilli bashkiak.

3.2. KËSHILLTARËT MARRIN FJALËN

Gjatë periudhës së marrë në studim, këshilltarët e morë fjalën 8,300 herë. Frekuenca e marrjes së fjalës është më e lartë gjatë muajit dhjetor (41%) dhe më e ulët gjatë muajit gusht (7.83%). Takimet e muajit dhjetor janë zakonisht më të gjata pasi këshilltarët diskutojnë projekt-buxhetin, kështu që edhe frekuenca e marrjes së fjalës është më e lartë. (Shtojca A, Tabela A2, paraqet frekuencën e marrjes së fjalës sipas muajit.)


Hendeku gjinor në marrjen e fjalës është i lartë. Konkretisht, burrat e morën fjalën 6,169 herë (74.33%) dhe gratë e morën fjalën 2,131 herë (25.67%). Figura 1 paraqet hendekun gjinor në marrjen e fjalës.

Figura 1: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas gjinisë




Hendeku gjinor vihet re gjatë të gjithë periudhës. Gjatë të gjithë muajve të marrë në studim, burrat e morën fjalën në më shumë se 70% të rasteve. Figura 2 paraqet numrin e herëve që këshilltarët e morën fjalën gjatë periudhës gusht – dhjetor 2023, të ndarë më tej sipas gjinisë.

Figura 2: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas muajit dhe gjinisë




Burrat dominojnë diskutimet në të gjitha këshillat e marrë në studim. Dominimi i burrave në diskutime ndihet veçanërisht në këshillin bashkiak të Korçës (81.05%), Malësisë së Madhe (84.80%), Pukës (80.97%), dhe Sarandës (85.53%). Figura 3 paraqet numrin e herëve që këshilltarët kanë marrë fjalën—të ndarë sipas gjinisë—në secilin këshill bashkiak.

Figura 3: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas këshillit bashkiak dhe gjinisë



Gjatë transkriptimit të regjistrimeve, grupi i punës theksoi rastet kur këshilltarëve iu ndërpre fjala. Ndërprerja e fjalës mund të vinte nga Kryetari i këshillit, këshilltarë të tjerë, apo administrata e Bashkisë. Grupi i punës evidentoi 977 raste të ndërprerjes së fjalës (11.77%). Krahasimi midis grave dhe burrave nxorri në pah se grave u ndërpritet fjala më shpesh. Konkretisht, grave ju ndërpre fjala 453 herë nga 2,131 herë që e morën fjalën (21.26%); ndërkohë, burrave ju ndërpre fjala 524 herë nga 6,169 herë që e morën fjalën (8.49%). Me fjalë të tjera, grave u ndërpritet fjala rreth 2.5 herë më shpesh se burrave. Figura 4 paraqet frekuencën e ndërprerjes së fjalës sipas gjinisë.


Figura 4: Frekuenca e ndërprerjes së fjalës gjatë diskutimeve



NDRYSHIME NË KOHË

Frekuenca me të cilën burrat e morën fjalën në vitin 2023 (74.33%) ishte më e lartë se në vitin 2018 (65.66%) dhe vetëm pak më e ulët se në vitin 2016 (76.09%). Ndërkohë, frekuenca me të cilën gratë e morën fjalën në vitin 2023 (25,67%) ishte më e ulët se në vitin 2018 (34,34%) dhe vetëm pak më e lartë se në vitin 2016 (23,91%). Figura 5 paraqet ndryshimin në kohë.

Figura 5: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës sipas gjinisë dhe vitit



3.3. KËSHILLTARËT DISKUTOJNË RRETH CILËSISË SË QEVERISJES

Diskutimet e këshilltarëve u analizuan sipas tri temave që lidhen me cilësinë e qeverisjes: zbatimi i ligjit, transparenca, dhe paanësia.¹⁷ Tema e transparencës i referohet kritikave ndaj zyrtarëve të Bashkisë për fshehjen e informacionit, paraqitjen e informacionit të pjesshëm, apo mosdhënien e informacionit. Këshilltarët kërkojnë informacion të plotë dhe të qartë, për shembull në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga zyrtarët e Bashkisë, fondet, investimet e parashikuara, apo shpërndarjen e ndihmës ekonomike. Këshilltarët kërkojnë sqarime, saktësime, shifra, arsye, përgjigje, ballafaqime. Për shembull, këshilltarët u drejtohen zyrtarëve të Bashkisë dhe thonë: “A mund të më sqarojë dikush”, “Dua arsyen pse,” “Cilat janë shkaqet?” “Cila është arsyeja?” “Duam shifra,” “Duhet të informohemi,” “Jepni një përgjigje,” “Ku bazoheni për këtë vendim?” “Kush ka përfituar?” “Në bazë të cilave kriteret?” “Si është llogaritur?” “Pse nuk janë marrë në konsideratë?” “Duhet të më shpjegojë,” “Duhet të jenë të dokumentuara,” “Duhet të na vendosni në dispozicion.” Shembuj të fjalëve kyçe që u përdorën për analizimin e takimeve të këshillave bashkiake janë: afishimet, dëgjesa, dokumentacioni, errësirë, foto, informacion, konsultim, media, pseudokonsultim, shifra, sqarim, transparenca, video, TV, zëri.

Tema e zbatimit të ligjit i referohet kritikave ndaj zyrtarëve të Bashkisë për shkeljen e ligjeve, moszbatimin e ligjeve, apo lënien pas dore të zbatimit të procedurave ligjore. Gjatë diskutimeve me zyrtarët e Bashkisë, këshilltarët i referohen “akteve ligjore,” “bazës ligjore,” “të drejtës juridike,” “të drejtës kushtetuese,” “fuqisë juridike,” “shkeljeve ligjore,” “shkeljeve të procedurave,” “statusit juridik,”




17 Për një diskutim të zgjeruar të tre temave shih Dauti, Marsela. 2022. “Bystanders or Contesters? Women’s Political Representation and Quality of Government in the Local Councils of Albania.” *Journal of Women, Politics & Policy* 44 (3): 274–98.

“zbatimit të vendimeve,” apo SPAK-ut. Shembuj të fjalëve kyçe të përdorura gjatë analizës janë: akte, auditet, dejure, dispozitë, drejtësinë, gjykata, informalitet, klsh, kushtetuta, legjislacion, ligj, neni, padi, penale, spak.

Tema e paanësisë i referohet kritikave ndaj zyrtarëve të Bashkisë për trajtim preferencial, apo shpërndarjen e burimeve dhe mundësive përmes lidhjeve klienteliste ose korrupsionit. Gjatë diskutimeve me zyrtarët e Bashkisë, këshilltarët flasim për “asfalt elektoral,” “blerje votash,” “hajdutë me çizme,” “çerdhe patronazhistash,” “vesh të shurdhët,” “të drejtën morale,” “lidhje klienteliste,” “mullinjte e erës,” “ndarje të padrejtë,” “ndragetën,” “qoka politike,” “qoka për fushatë elektorale,” “paratë rrush e kumbulla,” “pastrim të listave,” “sfilatë mode,” apo “shpërdorim fondesh.” Shembuj të fjalëve kyçe të përdorura gjatë analizës janë: abuzim, babëzi, diskriminim, fasadë, fukarai, hallexhi, klienteliste, kumbulla, lulkat, pabarazi, padrejtësi, patronazhist, pong, qoka, thasë. (Shih Shtojcën E për listën e plotë të fjalëve kyçe të përdorura për analizimin e mbledhjeve të këshillave bashkiake në lidhje me të tri temat.)

Analizimi i të dhënave nxorri në pah se këshilltarët janë më të shqetësuar për zbatimin e dobët të ligjit, e ndjekur kjo nga mungesa e transparencës. Adresimi i shqetësimeve të lidhura me paanësinë nuk ka qenë shumë në fokusin e këshilltarëve. Konkretisht, këshilltarët e morën fjalën 1,182 herë (14.24%) që të diskutonin çështje të lidhura me zbatimin e ligjit, 1,024 herë (12.34%) që të diskutonin çështje të lidhura me transparencën, dhe 174 herë (2.10%) që të diskutonin çështje të lidhura me paanësinë. Figura 6 paraqet frekuencën e marrjes së fjalës sipas të tri temave.


Figura 6: Frekuenca e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes



I njëjti përfundim mund të nxirret edhe për intensitetin e diskutimeve, i cili bazohet në numrin e fjalëve që përdorin këshilltarët pasi e marrin fjalën. Këshilltarët janë më të përfshirë në diskutimin e shqetësimeve që lidhen me zbatimin e ligjit dhe mungesën e transparencës. (Shih Shtojcën B, Tabela B3 për intensitetin e diskutimeve sipas të tri temave.)

Të dhënat tregojnë se burrat, krahasuar me gratë, kanë më shumë gjasa të marrin fjalën dhe të diskutojnë çështje që lidhen me zbatimin e ligjit. Konkretisht, burrat e morën fjalën 910 herë (14.75%) për të diskutuar rreth kësaj teme, ndërkohë gratë e morën fjalën 272 herë (12.76%). Po ashtu, burrat, krahasuar me gratë, janë më të përfshirë në diskutime ku adresojnë zbatimin e dobët të ligjit. Nuk u vunë re diferenca përsa i përket dy temave të tjera. Burrat dhe gratë, statistikisht, kanë të njëjtën gjasë të diskutojnë rreth transparencës dhe paanësisë. Figura 7 paraqet frekuencën e marrjes së fjalës sipas të tri temave dhe gjinisë.


Figura 7: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes—sipas gjinisë



NDRYSHIME NË KOHË

Diskutimet e këshilltarëve me në fokus përmirësimin e cilësisë së qeverisjes kanë qenë më të shpeshta në të kaluarën. Për shembull, përqindja e herëve që këshilltarët e morën fjalën për të diskutuar zbatimin e ligjit në 2023 ishte 14.24; ndërkohë, kjo përqindje për vitin 2018 ishte 28.56 dhe për vitin 2016 ishte 29.99. Pra, krahasuar me vitin 2018, në vitin 2023 këshilltarët kanë diskutuar rreth zbatimit të ligjit rreth 2 herë më pak. I njëjti konkluzion qëndron edhe në lidhje me transparencën. Në vitin 2023, krahasuar me vitet 2018 dhe 2016, këshilltarët diskutuan rreth 2 herë më pak për transparencën. Ndryshimi më i madh në kohë doli në pah në lidhje me paanësinë, ku këshilltarët, në vitin 2023, e morën fjalën vetëm 174 herë për të adresuar shqetësime që lidhen me mungesën e paanësisë. Figura 8 prezanton frekuencën e marrjes së fjalës në lidhje me tri temat në 2016, 2018, dhe 2023.


Figura 8: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—cilësia e qeverisjes—sipas vitit



Një mënyrë interpretimi i këtij rezultati është që në vitin 2023, krahasuar me vitin 2016 dhe vitin 2018, këshilltarët kanë punuar më pak për përmirësimin e cilësisë së qeverisjes vendore. Po ashtu, këshilltarët duket të jenë më pak të ndjeshëm ndaj padrejtësive dhe pabarazive.

Një tjetër ndryshim në kohë lidhet me diferencat gjinore. Ndërkohë që në vitet 2016 dhe 2018 gratë e morën fjalën më shpesh se burrat për të diskutuar rreth mungesës së transparencës, ky nuk ishte rasti në vitin 2023. Frekuenca e marrjes së fjalës si dhe intensiteti i diskutimeve rreth transparencës në vitin 2023, statistikisht, është i njëjtë për burrat dhe gratë. Ndërkohë, në vitin 2023, burrat, krahasuar me gratë, u përfshinë më intensivisht në diskutimin e temës së zbatimit të ligjit. Figura 9 paraqet frekuencën e marrjes së fjalës në lidhje me zbatimin e ligjit dhe transparencën në të tri vitet e studiuara.

Figura 9: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—zbatimi i ligjit dhe transparenca—sipas gjinisë dhe vitit




3.4. KËSHILLTARËT DISKUTOJNË RRETH SHËRBIMEVE VENDORE

Diskutimet e këshilltarëve u fokusuan kryesisht në shërbimet e mëposhtme: arsimit, shërbimet publike (p.sh., pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi), mirëqenia sociale, infrastruktura rrugore dhe transporti, ujësjellësi, dhe emergjencat/fatkeqësitë. Por, këto nuk ishin shërbimet e vetme që u diskutuan nga këshilltarët. Tema të tjera përfshinë, si për shembull, shëndetësinë, sportet dhe turizmin. Megjithatë, këto tema u diskutuan më pak dhe ishin në fokus të diskutimeve vetëm në disa prej këshillave bashkiake.

Në mënyrë të ngjashme me cilësinë e qeverisjes, analizimi i të dhënave rreth shërbimeve u bë në bazë të diskutimeve në mbledhjet e këshillave bashkiake. Për shembull, disa nga fjalët që u përdorën gjatë diskutimit të arsimit ishin arsimtarët, biblioteka, ekselent, klasa, konvikt, libra, parauniversitar, shkolla, universitet, zva. Apo, gjatë diskutimit të shërbimeve publike u përdorën fjalë të tilla si drita, gjelbërim, kënetave, koshat, llambë, lulishte, ndriçim, pastrim, pemë, plehra. Ndërsa, gjatë diskutimit të mirëqenies sociale u përdorën fjalë të tilla si asistencë, azilet, bonus, fukarait, kemp, pensionist, pikëzim, strehim, subvencion, tetraplegjik. (Shih Shtojcën E për listën e plotë të fjalëve kyçe të përdorura për analizimin e diskutimeve rreth shërbimeve.)

Këshilltarët e morën fjalën më shpesh për të diskutuar rreth infrastrukturës rrugore dhe transportit (10.01%) si dhe rreth arsimit (9.53%), ndjekur nga mirëqenia sociale (8.67%), shërbimet publike (7.94%), emergjencat/fatkeqësitë (7.75%), dhe ujësjellësi (6.94%). Figura 10 paraqet frekuencën e marrjes së fjalës sipas shërbimeve.


Figura 10: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas shërbimeve



Temat për të cilat këshilltarët diskutuan më intensivisht—bazuar në raportin e fjalëve të përdorura—ishin infrastruktura rrugore dhe transporti si dhe arsimiti.

Burrat, krahasuar me gratë, e morën fjalën më shpesh për të diskutuar rreth shërbimeve publike, ujësjellësit, dhe emergjencave/fatkeqësive. Diferencat ishin statistikiisht domethënëse. Pothuajse për të gjitha shërbimet e analizuar—me përjashtim të arsimit—gratë e morën fjalën më pak se burrat. Megjithatë, edhe në rastin e arsimit, diferenca me burrat është shumë e vogël. Figura 11 prezanton frekuencën e marrjes së fjalës sipas shërbimeve dhe gjinisë.

Figura 11: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës sipas shërbimeve dhe gjinisë




Pasi e marrin fjalën, burrat angazhohen në mënyrë më intensive në diskutimin e shërbimeve publike, mirëqenies sociale, infrastrukturës rrugore dhe transportit, ujësjellësit, emergjencave/fatkeqësive. E vetmja fushë, nga 6 fushat e analizuar, ku gratë dhe burrat diskutojnë me të njëjtin intensitet është ajo e arsimit. (Shih Shtojcën C, Tabela C4 për intensitetin e diskutimeve sipas shërbimeve dhe gjinisë.)

NDRYSHIME NË KOHË






Në vitin 2023, krahasuar me vitet 2016 dhe 2018, këshilltarët e morën fjalën më shpesh për të diskutuar rreth arsimit, shërbimeve publike, infrastrukturës rrugore dhe transportit, dhe ujësjellësit. Rritja ka qenë e konsiderueshme veçanërisht për diskutimet rreth infrastrukturës rrugore dhe transportit si dhe ujësjellësit. Ndërkohë, këshilltarët kanë diskutuar më pak rreth mirëqenies sociale, një tendencë kjo e vënë re veçanësisht në Bashkitë me zhvillim më të lartë ekonomik. Figura 12 paraqet frekuencën e marrjes së fjalës në kohë.

Figura 12: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—shërbimet—sipas vitit



Në vitin 2016 dhe në vitin 2018, gratë, krahasuar me burrat, kishin më tepër gjasa të merrnin fjalën dhe të diskutonin rreth arsimit. Kjo diferencë, statistikisht, nuk ekziston në vitin 2023. Në vitin 2016, burrat kishin më shumë gjasa se gratë të merrnin fjalën dhe të diskutonin rreth shërbimeve publike. Diferenca u zbut në vitin 2018, por u thellua në vitin 2023. Në vitin 2016, burrat kishin më shumë gjasa se gratë të merrnin fjalën dhe të diskutonin rreth mirëqenies sociale. Kjo diferencë u përmbys në vitin 2018, kur angazhimi i grave në diskutimin e mirëqenies sociale u rrit dukshëm. Diferenca, statistikisht, nuk ekziston në vitin 2023. Ndërkohë është thelluar hendeku përsa i përket marrjes së fjalës dhe diskutimeve rreth ujësjellësit. Në vitin 2023, burrat, krahasuar me gratë, e kanë marrë fjalën më shpesh për të diskutuar rreth ujësjellësit. Megjithatë, problemet e lidhura me ujësjellësin kanë qenë më shumë në fokus të diskutimeve të këshilltarëve në vitin 2023 sesa në vitet 2016 dhe 2018. Me rritjen e frekuencës së diskutimeve është thelluar hendeku gjinor. Figura 13 paraqet frekuencën e marrjes së fjalës sipas vitit për secilin shërbim të studiuar.

Figura 13: Frekuenca (%) e marrjes së fjalës—shërbimet—sipas gjinisë dhe vitit



Të dhënat tregojnë se arsimi dhe mirëqenia sociale—dy fushat që dominoheshin nga gratë në vitin 2018—në vitin 2023 janë dominuar në mënyrë të barabartë nga gratë dhe burrat. Shërbimet publike dhe ujësjellësi—të cilat dominoheshin nga gratë dhe burrat, në mënyrë të barabartë në vitin 2018—u dominuan nga burrat në vitin 2023. Gratë, statistikisht, nuk dominuan në asnjë fushë në vitin 2023.

3.5. KËSHILLTARËT SHPJEGOJNË NDRYSHIMET NË KOHË

CILËSIA E QEVERISJES

Për këshilltarët e intervistuar, pakësimi i diskutimeve me në fokus përmirësimin e cilësisë së qeverisjes vendore është i lidhur ngushtësisht me zhvillimet politike në nivel vendor, edhe gjithashtu qendror. Pika e kthesës, shpjeguan këshilltarët, ishte viti 2019—kohë kur shumë këshilla bashkiake u mbizotëruan nga një parti e vetme. Diskutimet, kritikrat, apo pyetjet drejtuar administratës u zvogëluan dukshëm. Nga ana e saj, administrata e Bashkisë nuk i kushtoi shumë vëmendje raportimeve. Një prej pjesëmarrësve në studim, i cili kishte shërbyer për disa mandate në këshill, tha se përpara transformimit të këshillave në “një-partiake,” administrata ishte më e përgatitur, i merrte më seriozisht kërkesat, dhe angazhimi i këshilltarëve ishte më impenjativ. Me largimin e opozitës, mbledhjet ishin të shkurtra dhe kryesisht konsistonin në aprovimin e projektvendimeve. Roli mbikëqyrës i këshilltarëve u dobësua, gjë e cila u reflektua edhe në kërkesat drejtuar stafit të Bashkisë. Edhe sot, këshilltarët e partisë në pushtet shpesh janë të kujdesshëm kur dhe si i bëjnë kritikrat, apo gjejnë forma të tjera, jo-publike, si në kafene apo në zyrën e drejtuesit/es së Bashkisë për të nxjerrë në pah pakënaqësi apo për të bërë kërkesa.

Ky përfundim mbështetet edhe nga vëzhgimet tona në terren. Në vitin 2023, stafi i Bashkisë ishte shumë pak i përfshirë në dhënien e përgjigjeve apo sqarimeve, krahasuar me vitin 2016 dhe vitin 2018. Kryesisht, përgjigjet i jepnin Kryetarët apo Nënkyetarët e Bashkive, apo, në disa raste, edhe Kryetarët e këshillave. Ndryshimet politike, siç shpjegoi një prej këshilltarëve, i kanë vendosur këshillat “nën trysinë” e drejtuesve të Bashkive.

Është e paqartë përse nga të tri temat tek të cilat u fokusuan—zbatimi i ligjit, transparenca, dhe paanësia—ajo për të cilën diskutimet duken të jenë dobësuar më shumë është paanësia. Me fjalë të tjera, në vitin 2023, krahasuar me vitin 2016 dhe vitin 2018, këshilltarët duket të jenë më pak të shqetësuar për pabarazitë apo padrejtësitë. Një shpjegim i mundshëm është që centralizimi i pushtetit ka dobësuar dukshëm funksionin përfaqësues të këshilltarëve. Me fjalë të tjera, këshilltarët janë më shumë të fokusuar tek partia sesa tek komuniteti. Një tjetër shpjegim është që padrejtësitë dhe pabarazitë në sytë e këshilltarëve mund të jenë “normalizuar,” dhe tanimë u bëjnë më pak përshtypje. Ndërkohë, në vitin 2023 këshilltarët ishin më të angazhuar në diskutime që lidhen me zbatimin e ligjit. Hovi i këshilltarëve duket të jetë ndikuar edhe nga SPAK, pasi në plot raste këshilltarët iu referuan SPAK-ut për të vënë në pah se do të merrnin masa ndaj korrupsionit apo abuzimeve me pushtetin. Këto propozime erdhën nga kryetarët e grupeve politike opozitare.

HENDEKU GJINOR

GRATË LARGOHEN APO HEQIN DORË DHE NUK RIKANDIDOJNË

Ky fenomen, i cili u diskutua nga disa këshilltarë, mund të shpjegojë, pjesërisht, thellimin e hendekut. Nëse këshilltarët largohen apo heqin dorë—dhe nuk ndërtojnë eksperiencë të gjatë në këshillat bashkiake—atëherë rezultati mund të sjellë këshilla bashkiake me burra që i kanë të konsoliduara pozitat e tyre dhe gra që duhet ta nisin gjithmonë nga fillimi. Në këtë situatë, burrat riafirmojnë pozitat e tyre duke lënë gratë jashtë diskutimeve. Nga intervistat, mësuam disa arsye se përse gratë nuk rikandidojnë. E para, drejtuesit e partive vendosin të zëvendësojnë gratë. Me fjalë të tjera, edhe nëse

gratë kanë dëshirë të rikandidojnë, ato nuk kanë mundësi. Këshilltaret diskutuan për demokracinë e dobët brenda partive politike, duke theksuar se rikandidimi nuk është në dorën e tyre—pavarësisht kontributit të tyre në komunitet. E dyta, gratë heqin dorë për shkak të eksperiencave jo të mira, sidomos kur shohin se propozimet e tyre nuk merren në konsideratë apo që fjala e tyre ndërpritet shpesh. Ky shpjegim u dha nga një numër këshilltaresh, të cilat shpjeguan se kërkesat e grave bien në vesh të shurdhët dhe ato vendosin të tërhiqen. Këtë vendim e kishte marrë edhe një prej pjesëmarrëseve në studim, e cila ishte në fillimin e mandatit të saj të parë. Kështu që hendeku që ne vëzhgojmë mund të reflektojë dekurajimin e grave në këshill. E treta, gratë largohen nga këshillat për shkak të presionit që u bëhet nga drejtuesit e partisë. Ky fenomen nuk ka marrë vëmendje deri tani. Partitë politike respektojnë kuotën gjinore kur dorëzojnë listat në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por pas zgjedhjeve u bëjnë presion grave të tërhiqen në masë për t'ua lënë vendin burrave. Një formë presioni është kërcënimi për heqjen nga puna. Në një prej këshillave ne mësuam se ishin tërhequr më shumë se 10 gra për t'ia lënë vendin një burri! Kjo strategji ka efekte shumë negative tek gratë që janë pjesë e politikës apo që synojnë të bëhen pjesë e politikës në të ardhmen. Ajo legjitimon idenë që politika u përket burrave dhe gratë janë në shërbim të tyre.

BURRAT SHFAQIN REZISTENCË NDAJ PËRFSHIRJES SË GRAVE NË DISKUTIME DHE RIAFIRMOJNË DOMINANCËN PËRMES TAKTIKAVE TË NDRYSHME

Shumë nga këshilltaret, të cilat morën pjesë në studim, vunë në pah një numër padrejtësish që përjetonin kur e merrnin fjalën. Konkretisht, atyre u ndërpritej fjala, u lihej një kohë e shkurtër për të ndarë mendimet e tyre, nuk u kthehej përgjigje, apo propozimet e tyre nuk merreshin në konsideratë. Një nga këshilltaret, e cila ishte përfshirë prej 3 dekadash në politikë, tha se grave, krahasuar me burrave, u lihet më pak kohë të diskutojnë. Kur gratë e marrin fjalën, ato shpejtohen të mbarojnë. Këto probleme nuk haseshin vetëm në Bashkitë e vogla. Në fakt, në një prej mbledhjeve të mbajtura në një prej Bashkive më të mëdha në vend, një nga këshilltaret u tërhoqi vërejtje burrave të partisë së saj dhe të partive të tjera për mosrespektimin e kohës gjatë marrjes së fjalës, duke lënë pak kohë në dispozicion për gratë. Këshilltaret folën edhe për ofendime që marrin, si p.sh. “U bëre ti!” apo “Ju nuk dini gjë!”, ofendime që ne i kemi evidentuar edhe vetë gjatë vëzhgimeve. Këto taktika, përveç të tjerave, reflektojnë edhe paragjykitime të brendësuar, të cilat orientohen nga besimi dhe ideja e gabuar se mendimet e grave janë më pak të rëndësishme.

GRATË PËRFSHIHEN MË FORT NË DISKUTIMET E KOMISIONEVE, NDËRKOHË BURRAT PËRFSHIHEN MË FORT NË DISKUTIMET E MBLEDHJEVE

Një tjetër shpjegim që u dha për përfshirjen e ulët të grave në diskutime ishte se kjo përfshirje fsheh një realitet tjetër: atë të përfshirjes së madhe të grave në diskutimet e komisioneve. Gratë diskutojnë fort në komisionet e këshillave, “aty ku bëhet realisht puna,” në fjalët e një këshilltari, por tërhiqen gjatë mbledhjes, duke ua lënë radhën kolegëve të tyre burra. Në këtë studim, ne u fokusuam vetëm në mbledhjet e këshillave dhe nuk kemi të dhëna për komisionet. Si rezultat, nuk mund të krahasojmë diferencën në diskutimet e komisioneve. Nëse angazhimi i grave është i madh në komisione, atëherë hendeku, në një farë mënyre, reflekton ndarjen gjinore të punës, të ngjashme me atë brenda familjes tradicionale: gratë bëjnë punën në komisione, ndërkohë burrat marrin meritat dhe vëmendjen mediatike në mbledhje. Kështu, gratë vihen në shërbim të burrave dhe i ndihmojnë ata të riafirmojnë pozitat e tyre në mbledhje, ndërsa vetë qëndrojnë në hije. Ajo çfarë na bëri përshtypje ishte që si gratë dhe burrat që e bënë dallimin midis komisioneve dhe mbledhjeve, në pjesën më të madhe të rasteve nuk e panë këtë ndarje gjinore të punës si shqetësuese.

EKSPERIENCA DHE SOCIALIZIMI NË POLITIKË

Një tjetër shpjegim është që—edhe pse përfshirja e grave në politikë është rritur dukshëm—duhet një kohë e gjatë që ato të socializohen në politikë dhe të ndërtojnë eksperiencë të pasur. Ky shpjegim, kryesisht, u bë nga burrat. Pjesë e këtij arsytimi ishte se mosmarrja e fjalës vinte nga pengesa që kishin vetë gratë, jo nga mjedisi politik ku gratë veprojnë. Për shembull, një nga këshilltarët tha se gratë janë të përgatitura por të ndrojtura, dhe ato stепен të marrin fjalën sepse mbledhjet janë online. Ky shpjegim, megjithatë, nuk na ndihmon për të kuptuar se përse është thelluar hendeku gjinor në kohë.

BURRAT PO DOMINOJNË, GRADUALISHT, FUSHËN QË TRADICIONISHT KA QENË PRIORITARE PËR GRATË PËR AVANTAZH ELEKTORAL

Të pyetur se përse angazhimi i burrave në diskutimin e arsimit është rritur dukshëm në kohë, këshilltarët u përgjigjën duke thënë se arsimit është tanimë një fushë prioritare, apo, siç tha një këshilltar, “prioritet i prioritetëve” për qeverinë qendrore dhe vendore. Si rezultat, interesat elektorale janë të mëdha. Një prej këshilltarëve solli shembullin e investimeve në territorin e Bashkisë së tij, duke thënë se pas tërmetit janë bërë shumë investime në infrastrukturën arsimore, duke bërë që një numër diskutimesh të fokusoheshin tek arsimit. Një tjetër shpjegim ishte se diskutimet me në fokus arsimin janë ngushtësisht të lidhura me akuzat për korrupsion dhe keqpërdorim të fondeve, akuza që kryesisht i bëjnë kryetarët (burra) e grupeve. Shpjegim tjetër ishte se përbërja e këshillave ka ndryshuar: numri i burrave që vijnë nga sektori i arsimit është rritur. Megjithatë, nuk kemi të dhëna për ta testuar këtë.

NUMRAT SI PENGESË PËR TË AVANCUAR

Barazia numerike jo rrallë po përdoret për të penguar nismat që synojnë forcimin e pozitive të grave në politikë. Një prej këshilltareve ndau eksperiencën e saj: propozimi për krijimin e një komisioni me në fokus barazinë gjinore u kundërshtua nga kolegët burra me argumentin se të drejtat e grave janë përmbushur tashmë dhe ky lloj komisioni nuk është i nevojshëm. Një tjetër shqetësim ishte se nismat e këshilltareve që synojnë mbështetjen e grave nuk mbijetojnë në kohë—me fjalë të tjera, nga një mandat tek tjetri—ç’ka sugjeron mungesë qëndrueshmërie.

KËNDVËSHTRIMET E BURRAVE RRETH HENDEKUT GJINOR JANË SHUMË TË NDRYSHME NGA KËNDVËSHTRIMET E GRAVE

Burrat, kryesisht, e cilësuan përfshirjen e ulët të grave në diskutime si një “preferencë personale” apo “mosdëshirë të grave.” Disa nga reagimet e tyre—në përgjigje të pyetjes se përse burrat dominojnë diskutimet—ata iu përgjigjën duke thënë: “Nuk shoh mundësi diskriminimi,” “Barazia është e vendosur me ligj,” “Nuk është që i pengon njeri,” “Realisht pengesa nuk ekziston.” Një nga këshilltarët tha: “Është njësoj që unë të të ul në tavolinë, edhe pastaj nuk mund të të detyroj, të të them që ha ose pi, boll që je ul në tavolinë.” Burrat e prezantuan situatën si të çliruar nga pengesat dhe, përtej këshillave bashkiake, sollën shembuj nga qeveria për të theksuar barazinë numerike që për ta fliste për forcimin e rolit të grave në politikë. Ndërkohë, gratë i shihnin shkaqet e problemit të lidhura me partitë politike, dinamikat brenda këshillave bashkiake, dhe administratën vendore.

4. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Në vitin 2011, 23.7% e këshillave vendore (87 Komuna dhe 4 Bashki) nuk kishin asnjë grua.¹⁸ Sot, prezenca numerike e grave është rritur në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha nivelet e qeverisjes, me përjashtim të kryesive të fshatrave që vazhdojnë ende të dominohen nga burrat. Këto arritje numerike kanë bërë që Shqipëria të renditet krahas vendeve të zhvilluara. Zyrtarët politikë, plot zell, e përmendin këtë fakt sa herë që u jepet mundësia, duke sinjalizuar se partia e tyre mbështet progresin dhe demokratizimin e vendimmarrjes, edhe pse në realitet demokracia brenda partive politike është dobësuar.¹⁹ Narrativa e rritjes së përfaqësimit të grave në politikë, në fjalët e një këshilltareje, përdoret “për ta prezantuar situatën më rozë nga çfarë është realisht,” një situatë që në literaturë njihet me termin “genderwashing.”²⁰

Ne e realizuam studimin për të parë në mënyrë objektive se çfarë është duke ndodhur në këshillat bashkiake. Duke marrë si pikë fillestare vitin 2016—një vit pas rritjes masive të numrit të grave në këshillat bashkiake—ne krahasuam angazhimin e grave dhe burrave në diskutime në tri periudha të ndryshme kohore. Metoda kryesore që përdorëm ka si avantazh sigurimin e të dhënave që mbështeten në sjelljen e vëzhguar dhe jo në sjelljen e raportuar. Një nga sfidat në studimin e përfaqësuesve politikë është që raportimet e tyre prirën të mos lidhen ngushtësisht me sjelljen pasi janë të shqetësuar për pritshmëritë sociale apo reputacionin e tyre në parti dhe komunitet.²¹ Për këtë arsye, vëzhgimi i sjelljes konsiderohet një metodë e rëndësishme për grumbullimin e informacionit.

Studimi nisi me një sërë pritshmëri, ndër të cilat ishte që angazhimi i grave në diskutime është rritur në kohë. Duke qenë se rritja numerike e grave në këshillat bashkiake po mbush—vitin që vjen—një dekadë, ne parashikuam se rritja ka lënë disa shenja pozitive, ndër të cilat, e pakta, është që mbledhjet nuk dominohen vetëm nga një gjini.

Gjetjet prezantojnë një panoramë, të cilën mund ta cilësojmë si dekurajuese apo edhe dëshpëruese. Statistikisht, ne nuk evidentuam asnjë fushë ku të kishte patur një lloj progresi për gratë, krahasuar me burrat. Në fakt, e kundërta qëndron. Burrat kanë forcuar pozitat e tyre dominuese në këshill, karshi grave. Në mënyrë ironike, rritja numerike e grave në këshillat bashkiake duket se i ka shërbyer më shumë burrave—duke forcuar pozitat e tyre gjatë mbledhjeve. Ajo që del në pah nga krahasimi në kohë është se fushat që dominoheshin nga gratë në vitin 2018, nuk dominohen më nga to në vitin 2023. Fushat që dominoheshin nga burrat dhe gratë në mënyrë të barabartë në 2018, u dominuan nga burrat në vitin 2023. Edhe një fushë e re, emergjencat/fatkeqësitë, e shtuar në vitin 2023, u dominua nga burrat. Gratë, statistikisht, nuk dominojnë në asnjë fushë në vitin 2023. Të dhënat nxjerrin në pah se hendeku gjinor në këshillat bashkiake është thelluar.

Kjo nuk do të thotë që gratë nuk bëjnë asnjë përpjekje. Në fakt, ne evidentuam raste kur gratë vunë në pah hendekun gjinor dhe propozuan ndryshime. Konkretisht, këshilltaret advokuan për: alokim fondi



- 18 Dauti, Marsela, and Eglantina Gjermeni. 2015. Mapping Women’s Representation in the Local Councils of Albania. In S. P. Ramet & C. M. Hassenstab (Eds.), *Gender (In)equality and Gender Politics in Southeastern Europe: A Question of Justice* (pp. 213-228). New York, NY: Palgrave Macmillan.
- 19 Xhaferaj, Anjeza. 2022. “Matja e Demokracisë së Brendshme të Partive Politike në Shqipëri.” Tiranë, Shqipëri: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
- 20 Bjarnegard, Elin, and Pär Zetterberg. 2022. “How Autocrats Weaponize Women’s Rights.” *Journal of Democracy* 22 (2): 60–75.
- 21 Dauti, Marsela. 2022. “Measuring Gender Differences in Elite Behavior through Surveys versus Observation: What Does the Comparison Reveal?” *Politics, Groups, and Identities* 10 (4): 715–27.

për mbështetjen e grave në territorin e Bashkisë; rritjen e pjesëmarrjes së grave në votimin e kryesisë së fshatrave; pjesëmarrjen e të paktën një gruaje në komisionin votimi; pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në këshillin artistiko-kulturor; dhe respektimin e kohës që këshilltaret kanë të drejtë të marrin fjalën. Megjithatë, këto ishin raste sporadike, të pamjaftueshme për të nxitur ndryshim brenda këshillave apo për të çuar në rezultate statistikisht domethënëse.

Çfarë do të thotë kjo? Së pari, argumenti i rritjes numerike—i prezantuar nga partitë politike—duhet të shihet me skepticizëm dhe të kundërshtohen rastet kur ky argument përdoret për të thënë se gratë po ndikojnë fuqishëm në vendimmarrjen. Së dyti, organizatat politike dhe jo-politike duhet të punojnë për të adresuar pengesat që hasin gratë në politikë. Forumet politike, për shembull, mund të zhvillojnë programe specifike që fokusohen tek pengesat që këshilltaret kanë ndarë në këtë studim. Ne sugjerojmë bashkëpunime edhe me forumet e të rinjve.²² Po ashtu, sugjerojmë që forumet politike të grave të bëjnë pjesë të diskutimeve të tyre edhe burrat. Studimi nxorri në pah që këndvështrimet e burrave dhe grave janë të ndryshme. Gratë i shohin pengesat që hasin si sistematike—të rrënjësura thellë—ndërsa burrat priren t'i shohin problemet të lidhura me vetë gratë. Edhe pse ata folën plot respekt për koleget e tyre, përsëri përgjigjet që dhanë sugjeruan se nuk janë të vetëdijshëm për realitetet e grave si dhe e shohin situatën nga pozita të privilegjuara. Po ashtu, ne sugjerojmë që aleancat e këshilltareve të fokusohen tek pengesat që hasin gratë kur e marrin fjalën, për shembull faktin që ndërpriten më shpesh apo që burrat nuk respektojnë kohën e grave. Në të kaluarën, aleancat kanë mbështetur gratë në zhvillimin e propozimeve me në fokus gratë dhe grupe të tjera.²³ Një nga shqetësimet tona është që këto nisma duket se përforcojnë rolet tradicionale të grave. Ndërkohë që nismat janë të rëndësishme, gratë nuk duhet të kufizohen vetëm në përmbushjen e roleve tradicionale. E konsiderojmë disi emergjente që puna të fokusohet tek pengesat që hasin gratë brenda partisë, këshillit bashkiak, apo në lidhje me administratën. Ne sugjerojmë që të dhënat e prezantuara në këtë raport të përdoren për zhvillimin e fushatave nga vetë aleancat, si #MosMëNdërpre apo #PropozimilMëShtëIRëndësishëm. Mund të ketë plot ide të reja nga vetë aleancat.

Taktikat që përdoren për të injoruar apo nënvlerësuar gratë gjatë mbledhjeve nuk duhet të shihen si akte sporadike, por si rezistencë ndaj forcimit të rolit të grave në politikë.²⁴ Studimet tregojnë se kur prezenca e grave në politikë thyen stereotipet apo pritshmëritë sociale, ajo çon në kundër-reagime—si ngritje zëri, ofendime, apo taktika që synojnë t'i mbajnë gratë nën kontroll.²⁵ Taktikat e evidentuara në këtë studim mund të karakterizohen si dhunë psikologjike apo edhe ekonomike—në rastin e kërcënimeve për ndërprerjen e të ardhurave apo burimeve ekonomike—që ushtrohet ndaj grave dhe pengon avancimin e mëtejshëm të tyre në politikë.²⁶ Një nga sugjerimet tona është që këshilltaret—përmes forumeve apo aleancave—të organizohen dhe të kërkojnë që këtyre llojve taktikave t'i jepet fund. Shpesh, presionet apo padrejtësitë ndaj grave trajtohen si “kosto” të përfshirjes në politikë. Në fakt, ky lloj këndvështrimi përforcon idenë se gratë duhet të qëndrojnë kokëulur ndaj padrejtësive. Forumet dhe aleancat duhet t'i sfidojnë këto lloje këndvështrimesh dhe t'i trajtojnë taktikat si shkelje të të drejtave të



- 22 Për më shumë sugjerime në lidhje me përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar në politikë, shih Leskaj, Ines, & Edlira Ngjerci Shima. 2023. *Political Representation and Participation of Underrepresented Groups in the Electoral Process*. Tirana, Albania: Albanian Women Empowerment Network.
- 23 Bashki të Forta. 2019. “Aleancat e Grave në Këshillat Bashkiakë 2015-2019: Praktikat më të Mira.” Tiranë, Shqipëri: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.
- 24 Krook, Mona Lena. 2017. “Violence Against Women in Politics.” *Journal of Democracy* 28(1): 74–88; Sanín, Juliana Restrepo. 2022. “Violence against Women in Politics as an Unintended Consequence of Democratization.” *International Feminist Journal of Politics* 24(1): 16–39.
- 25 Herrick, Rebekah, and Sue Thomas. 2022. “Not Just Sticks and Stones: Psychological Abuse and Physical Violence among U.S. State Senators.” *Politics & Gender* 18(2): 422–47.
- 26 Dauti, Marsela, and Geldona Metaj. 2021. *Violence Against Women in Politics*. Tirana, Albania: United Nations Development Programme.

grave për përfshirje të plotë në politikë.²⁷

Studimi nxorri në pah se përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në mbledhjet e këshillave jo vetëm që është e vogël, por edhe në fokus e kufizuar në informimin e këshilltarëve. Ne sugjerojmë që organizatat t'i konsiderojnë mbledhjet si hapësira ku mund të advokojnë për grupet me të cilat punojnë dhe të zhvillojnë bashkëpunime me këshilltarët. Kjo lloj përfshirje është e domosdoshme, veçanërisht duke marrë në konsideratë zhvillimet e prezantuara në këtë raport kërkimor.

Disa sugjerime të tjera janë për organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e barazisë gjinore në politikë. Ne sugjerojmë që programet për zhvillimin e kapaciteteve të zgjerohen duke përfshirë edhe burrat. Po ashtu, organizatat mund të mbështesin nisma që fokusohen në adresimin e pengesave që hasin këshilltaret brenda këshillit bashkiak. Sugjerojmë edhe që progres-raportet të mos ndalen vetëm tek arritjet numerike, sepse fokusi vetëm tek to mund të dëmtojë avancimin e mëtejshëm të përfaqësimit të grave në politikë. Por ka edhe fusha të tjera, të cilat ne i konsiderojmë si të rëndësishme për të investuar, si demokracia e brendshme e partive dhe mbështetja e platformave të grave gjatë fushatave zgjedhore.

Nëse nuk ka një mobilizim të aktorëve lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtare me qëllim adresimin e pengesave që hasin këshilltaret, parashikojmë se do të shtohen rastet kur numrat e grave në këshillat bashkiake—apo edhe në nivele të tjera të qeverisjes—do të përdoren për të penguar avancimin e mëtejshëm të grave në politikë dhe për të dobësuar më tej demokracinë në vend.



27 Krook, Mona Lena. 2017. "Violence Against Women in Politics." *Journal of Democracy* 28(1): 74–88.

REFERENCAT

1. *Bashki të Forta*. 2019. "Aleancat e Grave në Këshillat Bashkiakë 2015-2019: Praktikrat më të Mira." Tiranë, Shqipëri: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.
2. Berevoescu, Ionica, and Julie Ballington. 2021. "Women's Representation in Local Government: A Global Analysis." New York, NY: UN Women.
3. Bjarnegård, Elin, and Daniela Donno. 2023. "Window-Dressing or Window of Opportunity? Assessing the Advancement of Gender Equality in Autocracies." *Politics & Gender*, 20 (1): 229–234. <https://doi.org/10.1017/S1743923X22000496>.
4. Bjarnegård, Elin, and Pär Zetterberg. 2022. "How Autocrats Weaponize Women's Rights." *Journal of Democracy* 22 (2): 60–75.
5. Bush, Sarah Sunn, and Pär Zetterberg. 2021. "Gender Quotas and International Reputation." *American Journal of Political Science* 65 (2): 326–41. <https://doi.org/10.1111/ajps.12557>.
6. Council of European Municipalities and Regions. 2019. "Women in Politics: Local and European Trends." Marrë nga: https://www.iknowpolitics.org/sites/default/files/cemr_study_women_in_politics_en.pdf.
7. Dauti, Marsela. 2021. "The Newcomer Effect: Gender Quotas, State Reforms and Service Responsiveness in Local Councils." *International Journal of Social Welfare* 30 (3): 330–41. <https://doi.org/10.1111/ijsw.12471>.
8. Dauti, Marsela. 2022. "Measuring Gender Differences in Elite Behavior through Surveys versus Observation: What Does the Comparison Reveal?" *Politics, Groups, and Identities* 10 (4): 715–27. <https://doi.org/10.1080/21565503.2021.1877751>.
9. Dauti, Marsela. 2023. "Bystanders or Contesters? Women's Political Representation and Quality of Government in the Local Councils of Albania." *Journal of Women, Politics & Policy* 44 (3): 274–98. <https://doi.org/10.1080/1554477X.2022.2109946>.
10. Dauti, Marsela, & Geldona Metaj. 2017. *Gender Quotas and Women's Substantive Representation in the Local Councils of Albania*. Tirana, Albania: United Nations Development Programme.
11. Dauti, Marsela, and Geldona Metaj. 2021. *Violence Against Women in Politics*. Tirana, Albania: United Nations Development Programme.
12. Dauti, Marsela, and Eglantina Gjermeni. 2015. *Mapping Women's Representation in the Local Councils of Albania*. In S. P. Ramet & C. M. Hassenstab (Eds.), *Gender (In)equality and Gender Politics in Southeastern Europe: A Question of Justice* (pp. 213–228). New York, NY: Palgrave Macmillan. <https://doi.org/10.1057/9781137449924>
13. Donno, Daniela, Sara Fox, and Joshua Kaasik. 2022. "International Incentives for Women's Rights in Dictatorships." *Comparative Political Studies* 55 (3): 451–92. <https://doi.org/10.1177/00104140211024306>.
14. Herrick, Rebekah, and Sue Thomas. 2022. "Not Just Sticks and Stones: Psychological Abuse and Physical Violence among U.S. State Senators." *Politics & Gender* 18(2): 422–47. doi:10.1017/S1743923X2000063X.
15. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 2011. "Zgjedhjet Vendore 2011: Të Dhëna për Numrin e Njësisive Vendore ku është Shkelur Kriteri Gjinor në Paraqitjen e Listave Shumëmërore për Këshill nga Partitë Politike." Tiranë, Shqipëri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
16. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 2015. "Të Dhëna mbi Kuotën Gjinore për Kandidimet në Zgjedhjet Vendore 2015." Marrë nga: http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/kuota_gjinore_kandidimet_Zgjedhjet_%20Vendore_%202015.pdf.

17. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 2019. "Zgjedhje vendore 2019 – Tabela Përmbledhëse." Marrë nga <https://cec.org.al/wp-content/uploads/2020/02/2019-Tabela-Permbledhese-Final-1.pdf>
18. Krook, Mona Lena. 2017. "Violence Against Women in Politics." *Journal of Democracy* 28(1): 74–88. doi:10.1353/jod.2017.0007.
19. Leskaj, Ines, & Edlira Ngjeci Shima. 2023. *Political Representation and Participation of Underrepresented Groups in the Electoral Process*. Tirana, Albania: Albanian Women Empowerment Network.
20. OSBE [Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut]. 2023. "Zgjedhjet Vendore 14 Maj, 2023: Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve." Varshavë.
21. Sanín, Juliana Restrepo. 2022. "Violence against Women in Politics as an Unintended Consequence of Democratization." *International Feminist Journal of Politics* 24(1): 16–39. doi:10.1080/14616742.2021.2014343.
22. UN Women. 2024. "Women in Local Government." Marrë nga: <https://localgov.unwomen.org/>
23. Valdini, Melody Ellis. 2019. *The Inclusion Calculation: Why Men Appropriate Women's Representation*. New York, NY: Oxford University Press. <https://doi.org/10.1093/oso/9780190936198.001.0001>.
24. Wängnerud, Lena. 2022. "Why Women in Elected Assemblies Reduce Levels of Corruption: The Indirect Approach." *Etica Pubblica. Stuid su legalità e partecipazione* 1: 13-28.
25. Xhaferaj, Anjeza. 2022. "Matja e Demokracisë së Brendshme të Partive Politike në Shqipëri." Tiranë, Shqipëri: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

SHTOJCAT

SHTOJCA A: FREKUENCA E MARRJES SË FJALËS

Tabela A1: Numri i takimeve sipas këshillit bashkiak

	n
Dimal	3
Durrës	5
Fier	4
Korçë	7
Kukës	5
Librazhd	3
Malësi e Madhe	2
Mat	8
Pukë	5
Sarandë	5
Tiranë	2
Totali	49

Shënim. Takimet u ndoqën gjatë periudhës gusht – dhjetor, 2023.

Tabela A2: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas muajit

	n	%
Gusht	650	7.83
Shtator	1,632	19.66
Tetor	1,257	15.14
Nëntor	1,358	16.36
Dhjetor	3,403	41.00
Totali	8,300	100

Tabela A3: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas muajit dhe gjinisë

	Burra n (%)	Gra n (%)	Totali
Gusht	473 (72.77)	177 (27.23)	650
Shtator	1,149 (70.40)	483 (29.60)	1,632
Tetor	959 (76.29)	298 (23.71)	1,257
Nëntor	969 (71.35)	389 (28.65)	1,358

Dhjetor	2,619 (76.96)	784 (23.04)	3,403
Totali	6,169 (74.33%)	2,131 (25.67%)	8,300

Tabela A4: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas këshillit bashkiak

	n	%
Dimal	348	4.19
Durrës	621	7.48
Fier	611	7.36
Korçë	2,148	25.88
Kukës	430	5.18
Librazhd	521	6.28
Malësi e Madhe	296	3.57
Mat	1,119	13.48
Pukë	1,193	14.37
Sarandë	698	8.41
Tiranë	315	3.80
Totali	8,300	100

Tabela A5: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas këshillit bashkiak dhe gjinisë

	Burra n (%)	Gra n (%)	Totali
Dimal	187 (53.74)	161 (46.26)	348
Durrës	401 (64.57)	220 (35.43)	621
Fier	423 (69.23)	188 (30.77)	611
Korçë	1,741 (81.05)	407 (18.95)	2,148
Kukës	325 (75.58)	105 (24.42)	430
Librazhd	373 (71.59)	148 (28.41)	521
Malësi e Madhe	251 (84.80)	45 (15.20)	296
Mat	728 (65.06)	391 (34.94)	1,119
Pukë	966 (80.97)	227 (19.03)	1,193
Sarandë	597 (85.53)	101 (14.47)	698
Tiranë	177 (56.19)	138 (43.81)	315
Totali	6,169 74.33	2,131 25.67	8,300

Tabela A6: Frekuenca e ndërprerjes së fjalës gjatë diskutimeve

	n	%
Burra	524	8.49
Gra	453	21.26
Totali	977	11.77

SHTOJCA B: DISKUTIMET E LIDHURA ME CILËSINË E QEVERISJES

Tabela B1: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas temës

	n	%
Zbatimi i ligjit	1,182	14.24
Transparenca	1,024	12.34
Paanësia	174	2.10

Tabela B2: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas temës dhe gjinisë

	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square
Zbatimi i ligjit	910 (14.75)	272 (12.76)	5.12*
Transparenca	768 (12.45)	256 (12.01)	0.28
Paanësia	139 (2.25)	35 (1.64)	2.88

Shënim. Numrat në kllapa u referohen përqindjeve. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

Tabela B3: Intensiteti i diskutimeve sipas temës

	Numri i fjalëve			Raporti i fjalëve		
	M	DS	Diapazoni	M	DS	Diapazoni
Zbatimi i ligjit	.30	1.59	0-74	.01	.04	0-1
Transparenca	.24	1.47	0-74	.008	.04	0-1
Paanësia	.03	.29	0-10	.0009	.015	0-1

Tabela B4: Intensiteti i diskutimeve sipas temës dhe gjinisë

	Numri i fjalëve			Raporti i fjalëve		
	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t
Zbatimi i ligjit	.31 (1.48)	.27 (1.87)	0.99	.011 (.05)	.007 (.03)	3.27**
Transparenca	.24 (1.35)	.23 (1.76)	0.32	.008 (.04)	.007 (.04)	1.37
Paanësia	.03 (.29)	.03 (.26)	0.88	.001 (.017)	.0004 (.009)	1.45

Shënim. Numrat në kllapa i referohen devijimit standard. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

SHTOJCA C: DISKUTIMET E LIDHURA ME SHËRBIMET VENDORE

Tabela C1: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas shërbimit

	n	%
Arsimi	791	9.53
Shërbimet publike	659	7.94
Mirëqenia sociale	720	8.67
Infrastruktura rrugore dhe transporti	831	10.01
Ujësjetësi	576	6.94
Emergjencat/Fatkeqësitë	643	7.75

Tabela C2: Frekuenca e marrjes së fjalës sipas shërbimit dhe gjinisë

	Burra n (%)	Gratë n (%)	Chi-square
Arsimi	579 (9.39)	212 (9.95)	0.58
Shërbimet publike	521 (8.45)	138 (6.48)	8.41**
Mirëqenia sociale	547 (8.87)	173 (8.12)	1.12
Infrastruktura rrugore dhe transporti	636 (10.31)	195 (9.15)	2.36
Ujësjetësi	464 (7.52)	112 (5.26)	12.59***
Emergjencat/Fatkeqësitë	502 (8.14)	141 (6.62)	5.13*

Shënim: Numrat në kllapa u referohen përqindjeve. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

Tabela C3: Intensiteti i diskutimeve sipas shërbimeve

	Numri i fjalëve			Raporti i fjalëve		
	M	DS	Diapazoni	M	DS	Diapazoni
Arsimi	.22	1.54	0-74	.007	.04	0-.81
Shërbimet publike	.16	1.41	0-74	.006	.035	0-1
Mirëqenia sociale	.17	1.41	0-74	.006	.036	0-.81
Infrastruktura rrugore dhe transporti	.24	1.61	0-74	.007	.039	0-1
Ujësjetësi	.14	1.40	0-74	.005	.033	0-.81
Emergjencat/Fatkeqësitë	.15	1.38	0-74	.006	.034	0-.81

Tabela C4: Intensiteti i diskutimeve sipas shërbimeve dhe gjinisë

	Numri i fjalëve			Raporti i fjalëve		
	Burra	Gra	t	Burra	Gra	t
Arsimi	.20 (1.38)	.26 (1.94)	-1.32	.007 (.04)	.007 (.04)	-0.09
Shërbimet publike	.17 (1.29)	.14 (1.70)	0.82	.006 (.04)	.004 (.03)	2.72**
Mirëqenia sociale	.18 (1.29)	.16 (1.71)	0.48	.006 (.04)	.004 (.03)	2.37*
Infrastruktura rrugore dhe transporti	.25 (1.53)	.20 (1.82)	1.24	.008 (.04)	.005 (.03)	2.58*
Ujësjetllësi	.15 (1.29)	.11 (1.66)	1.33	.006 (.03)	.004 (.03)	2.65**
Emergjencat/Fatkeqësitë	.16 (1.25)	.14 (1.70)	0.66	.006 (.04)	.004 (.03)	2.68**

Shënim. Numrat në kllapa i referohen devijimit standard. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

SHTOJCA D: NDRYSHIMET NË KOHË

Tabela D1: Frekuenca e marrjes së fjalës në 2016, 2018, dhe 2023 sipas gjinisë

	Burra n (%)	Gra n (%)	Totali
2016	3,720 (76.09)	1,169 (23.91)	4,889
2018	2,407 (65.66)	1,259 (34.34)	3,666
2023	6,169 (74.33%)	2,131 (25.67%)	8,300

Tabela D2: Frekuenca e marrjes së fjalës në 2016, 2018, dhe 2023 sipas temës

	2016 n (%)	2018 n (%)	2023 n (%)
Zbatimi i ligjit	1,466 (29.99)	1,047 (28.56)	1,182 (14.24)
Transparenca	1,158 (23.69)	1,009 (27.52)	1,024 (12.34)
Paanësia	1,311 (26.82)	1,015 (27.69)	174 (2.10)

Tabela D3: Frekuenca e marrjes së fjalës në 2016, 2018, dhe 2023 sipas temës dhe gjinisë

	2016			2018			2023		
	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square
Zbatimi i ligjit	1,116 (30.00)	350 (29.94)	0.001	680 (28.25)	367 (29.15)	0.33	910 (14.75)	272 (12.76)	5.12*
Transparenca	857 (23.04)	301 (25.75)	3.62	629 (26.13)	380 (30.18)	6.80**	768 (12.45)	256 (12.01)	0.28
Paanësia	1,010 (27.15)	301 (25.75)	0.89	689 (28.62)	326 (25.89)	3.08	139 (2.25)	35 (1.64)	2.88

Shënim. Numrat në kllapa u referohen përqindjeve. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

Tabela D4: Intensiteti i diskutimeve në 2016, 2018, dhe 2023 sipas temës dhe gjinisë

	2016			2018			2023		
	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t
Zbatimi i ligjit	.88 (2.70)	.89 (2.91)	-0.03	.77 (2.16)	.86 (2.72)	-1.0	.31 (1.48)	.27 (1.87)	0.99
Transparenca	.57 (1.97)	.79 (2.81)	-2.96**	.59 (1.62)	.82 (2.52)	-3.28**	.24 (1.35)	.23 (1.76)	0.32
Paanësia	.75 (2.59)	.73 (2.20)	0.26	.70 (1.94)	.86 (4.11)	-1.6	.03 (.29)	.03 (.26)	0.88

Shënim. Numrat në kllapa i referohen devijimit standard. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

Tabela D5: Frekuenca e marrjes së fjalës në 2016, 2018, dhe 2023 sipas shërbimit

	2016 n (%)	2018 n (%)	2023 n (%)
Arsimi	301 (6.16)	140 (3.82)	791 (9.53)
Shërbimet publike	246 (5.03)	112 (3.06)	659 (7.94)
Mirëqenia sociale	517 (10.57)	348 (9.49)	720 (8.67)
Infrastruktura rrugore dhe transporti	237 (4.85)	182 (4.96)	831 (10.01)
Ujësjetësi	66 (1.35)	65 (1.77)	576 (6.94)
Emergjencat/Fatkeqësitë	-	-	643 (7.75)

Tabela D6: Frekuenca e marrjes së fjalës në 2016, 2018, dhe 2023 sipas shërbimit dhe gjinisë

	2016			2018			2023		
	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square	Burra n (%)	Gra n (%)	Chi-square
Arsimi	170 (4.57)	131 (11.21)	67.81***	74 (3.07)	66 (5.24)	10.58**	579 (9.39)	212 (9.95)	0.58
Shërbimet publike	201 (5.40)	45 (3.85)	4.49*	75 (3.12)	37 (2.94)	0.09	521 (8.45)	138 (6.48)	8.41**
Mirëqenia sociale	417 (11.21)	100 (8.55)	6.63*	158 (6.56)	190 (15.09)	69.96***	547 (8.87)	173 (8.12)	1.12
Infrastruktura rrugore dhe transporti	183 (4.92)	54 (4.62)	0.17	120 (4.99)	62 (4.92)	0.006	636 (10.31)	195 (9.15)	2.36
Ujësjetësi	57 (1.53)	9 (0.77)	3.88	47 (1.95)	18 (1.43)	1.30	464 (7.52)	112 (5.26)	12.59***
Emergjencat/ Fatkeqësitë	-	-	-	-	-	-	502 (8.14)	141 (6.62)	5.13*

Shënim. Numrat në kllapa u referohen përqindjeve. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

Tabela D7: Intensiteti i diskutimeve në 2016, 2018, dhe 2023 sipas shërbimit dhe gjinisë

	2016			2018			2023		
	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t	Burra M (DS)	Gra M (DS)	t
Arsimi	.20 (1.34)	.63 (3.23)	-6.51***	.15 (1.31)	.26 (2.09)	-1.89*	.20 (1.38)	.26 (1.94)	-1.32
Shërbimet publike	.16 (1.03)	.12 (.80)	1.22	.08 (.70)	.07 (.53)	0.19	.17 (1.29)	.14 (1.70)	0.82
Mirëqenia sociale	.24 (1.19)	.24 (1.13)	-0.01	.19 (1.34)	.37 (1.54)	-3.63***	.18 (1.29)	.16 (1.71)	0.48
Infrastruktura rrugore dhe transporti	.16 (1.03)	.12 (.80)	1.22	.08 (.70)	.07 (.53)	0.18	.25 (1.53)	.20 (1.82)	1.24
Ujësjetësi	.05 (.55)	.01 (.19)	2.27	.05 (.51)	.04 (.44)	0.75	.15 (1.29)	.11 (1.66)	1.33
Emergjencat/ Fatkeqësitë	-	-	-	-	-	-	.16 (1.25)	.14 (1.70)	0.66

Shënim. Numrat në kllapa i referohen devijimit standard. * = $p < 0.05$, ** = $p < 0.01$, *** = $p < 0.001$.

SHTOJCA E: FJALËT KYÇE TË PËRDORURA PËR ANALIZIMIN E DISKUTIMEVE TË KËSHILLTARËVE

Tema	Fjalët kyçe
Zbatimi i ligjit	<i>akt, akte, aktet, akteve, ankimimit, apel, auditet, auditit, dejure, dejuro, dispozita, dispozite, dokumentacione, dokumentacioni, drejtesine, drejtesise, gjykata, gjykate, gjyq, hetim, informalitet, informaliteti, jashteligjshme, juridik, juridike, juridikisht, juristet, klsh, klshja, klshse, kompetencat, kompetencave, kqz, kushtetuta, kushtetutes, legjislacioni, legjislacionin, legjislacionit, legjistlacioni, legjitim, legjitime, ligj, ligjerisht, ligjesh, ligjet, ligjeve, ligji, ligjin, ligjit, ligjor, ligjore, ligjshem, ligjshme, logjika, maliqit, nligj, nenet, neni, nenin, nenit, nenligjore, ngjykat, obligimin, padi, paligjshme, penale, permarrim, permbarim, piramidat, procedur, procedura, procedurat, procedurave, procedure, procedures, procesverbale, projektligj, projektvendim, protokoll, rregullore, rregulloren, rregullores, rregullorja, sanksionesh, sanksioni, shkelja, shkelje, shkrese, shteterore, shteti, spak, spakut, tligjit, vendim, venim, vendimmarrje, vendimmarrja, vendimmarrjen, vendimet, vkm, vkmja, vkmse, vkb</i>
Transparenca	<i>afat, afishimet, afishimi, afishohet, afishu, afishuara, arsyeja, arsyet, audio, degjes, degjesa, degjesat, degjese, degjesen, degjeses, dokument, dokumentacioni, dokumentacionin, dokumentat, dokumentuara, erresire, foto, fotografia, fotot, hava, informacion, informacione, informacionet, informacioni, informacionin, informimit, informohemi, informohen, informohet, informuar, inventar, kashte, keshillimi, keshillimor, konsult, konsultativ, konsulte, konsultim, konsultime, konsultimet, konsultimesh, konsultimeve, konsultimi, konsultimin, konsultimit, konsultohen, konsultosh, konsultuar, lajv, live, logjika, media, median, mediat, mediatike, ndegjesa, nkonsultim, ojf, opendata, performance, performancen, pseudokonsultime, prezantim, publikimeve, publikisht, publikuar, pyes, qytetaret, shifra, sqarim, sjarime, studim, televizive, transparenca, transparence, transparencen, transparences, transparent, transparente, tv, ulerasim, video, zeri</i>
Paanësia	<i>abusive, abuzim, abuzime, abuzimet, abuzimeve, abuzimi, abuzive, babezi, balluku, barazi, bingo, burg, catine, cizme, diellit, diferencim, diferencimi, diskriminim, diskriminimin, diskriminimit, diskriminuar, dyfytyresi, evazion, fasada, fasade, favorizim, fiktive, fryrje, fukarai, fushate, galopante, genjeshter, geten, gjak, godasim, halle, hallexhi, hallexhinj, klecke, klienteliste, kompromentuar, korrupsion, korrupsioni, korruptive, kumbulla, lapsit, livadhisin, llastuar, lluksin, lulkat, manipuluar, mashtruar, miell, mjel, morale, moralisht, moralit, moralshme, ndershmeri, pabarazi, padrejte, padrejtesi, padrejtesie, padrejtesisht, pamoralshme, paragjyko, paragjykoj, pashpirtesi, patronazhist, patronazhistat, patronazhistesh, perlash, ping, pong, priftin, pseudoformalitet, qiell, qoka, qokat, qumshtin, rrasim, rrush, segmentuar, shina, shperdorim, shperdorimin, sfilate, spak, thase, tejfryre, tejfryrje, turp, turpshme, uzurpimi, vjedhje, vjedhjet, xero, zaptim, zverdheni</i>

Tema	Fjalët kyçe
Arsimi	<p><i>arsimi, arsimimit, arsimin, arsimit, arsimor, arsimore, arsimores, arsimtaret, arsimtareve, bebe, biblioteka, biblioteken, bibliotekes, biletën, bursa, bursat, bursave, canten, catia, cerdhe, cerdheve, detergjente, drusore, drute, edukative, edukatoret, edukim, edukimin, ekselent, ekselente, ekokampuse, ekokampusi, ekokampusit, femije, filllores, fizika, fletoren, fugon, fugonat, fugoni, gjimnaze, gjimnazi, gjimnazeve, gjimnazisti, informatika, kampusin, kimia, klasa, klasave, konvikt, konviktet, konviktin, konviktore, kopesht, kopeshti, kopshte, kopshtet, kopshteve, kopshti, kopshtit, kopshtin, krevatet, libra, lodra, mensat, mesim, mesimit, mesimor, mesues, mesuesve, mishin, msusin, ncerdhe, nentevjecare, nentvjecare, nkopshte, nxanes, nxansit, nxenes, nxenese, nxenesin, nxenesit, nxenesve, nxensit, nxensve, nxones, palestrat, parashkollor, parashkollore, parauniversitar, prinderit, prinderve, prindit, shkolla, shkollat, shkollave, shkollë, shkollen, shkollës, shkollor, shkollore, sobat, sobes, sportive, studentat, studentet, studentesh, studenteve, stufa, universitet, universitete, universitetin, zva</i></p>
Shërbimet publike	<p><i>drita, dritat, dritave, ecoparku, elektrikist, elektrikisti, elektrike, errsine, gjelber, gjelbera, gjelbra, gjelberim, gjelberimeve, gjelberimi, gjelberimin, gjelberimit, kanalizime, kanalizimet, kazaneve, kenetave, kontiner, kosh, koshat, landfill, llambe, llampat, llampave, lopate, lule, lulishte, lulishtet, mbetje, mbetjeve, mbeturinave, mbeturinat, miniparqeve, mosndricimi, ndricim, ndricimi, ndricimin, ndricimit, ndricues, ndricuesit, pandricuara, pastrim, pastrimi, pastrimin, pastrimit, peme, plehra, plehrave, plenat, plera, pusetat, qent, qente, qenve, qenvet, rekreacionit, zeza</i></p>
Mirëqenia sociale	<p><i>6%, asistence, azilet, azilja, banesa, banesat, banesave, bonus, bonuset, bonusi, bonusin, bonusit, buk, bukes, foshnjës, fukarait, egjiptian, egjiptian, ekonomike, emerore, invalidet, kemp, kempin, kempit, kredish, kredit, lgbt, logopedisti, lypsar, moshuarit, pastreha, pastrehe, pastrehet, pastrehut, pensionist, pensionistet, pensionisteve, pikezimin, pikezimit, qera, qeraje, qerase, qerate, qirane, qirase, qirate, qirave, rom, shtepi, social, strehim, strehimi, strehimit, subvencione, subvencionit, tetraplegjike, verber, verberve</i></p>
Infrastruktura rrugore dhe transporti	<p><i>aksidentesh, asfalt, asfalte, asfaltim, asfaltimi, asfaltimit, asfaltimet, asfaltimin, asfaltin, asfaltohet, asfaltoni, asfaltuar, autobuz, autobuza, autobuzash, autobuzave, autobuze, autostrada, autostrade, autostraden, autostrades, beton, biletën, fugon, fugonat, fugoni, furgon, furgonat, gropat, kanalet, kanalizime, kanalizimet, karroca, makinat, makine, mirembajtje, mirembajtjes, nderqytetas, nderqytetase, parkim, parkime, parkimet, parkimeve, parkimit, parkingjeve, pasagjeret, rampa, rampe, rampes, rera, rruga, rruge, rrugen, rruges, rruges, rruget, rrugeve, rrugore, rrugve, semaforet, sinjalistika, sinjalistike, sinjalistikë, sinjalistikën, sinjalistikës, tabelës, terminali, terminalit, trafikimit, trafikun, transport, transporti, transportime, transportimin, transportin, transportit, trenit, trotuar, trotuare, ura, ure, uren, ures, vijezim, vijezime, vijezimi, vijezimin, vizat, vizat</i></p>
Ujësjellësi	<p><i>amku, amkuse, bidon, cezëm, cezmat, hidrocentralet, hidrovorit, tubacioni, tubat, pijshëm, uj, uje, ujesjellësi, ujesjellesin, ujesjellesit, ujesjellsi, ujesjellsit, ujsjells, uji, ujin, ujit, ujrave, ujsjells, ujsjellsit, ujtin, ukd, ukdja</i></p>

Tema	Fjalët kyçe
Emergjencat/ Fatkeqësitë	<i>emegjenca, emergjenca, emergjencat, emergjencave, emergjence, emergjences, emergjenses, emergjente, fatkeqesite, kovidi, kovidit, natyrore, pallati, pallatit, pandemia, pandemise, permbyt, permbytje, permbytjes, permbytja, permbytjet, permbytna, permytjeve, pishat, rikonstruktimit, rindertim, rindertimi, rindertimit, rindertohet, rikonstruktim, rikonstruktimit, riparimit, shi, termeti, termetin, termetit, zjarr, zjarrefikese, zjarrefikse, zjarrefikseve, zjarrefiksja, zjarrefikesja, zjarrefikesve, zjarrefiksja, zjarrefikse, zjarri, zjarrit, zjarret, zjarreve</i>

SHTOJCA F: KARAKTERISTIKAT E KËSHILLTARËVE TË INTERVISTUAR

Këshilltarët u përzgjedhën nga 11 këshillat bashkiake ku u ndoqën mbledhjet. Në total, u intervistuan 20 këshilltarë (9 burra dhe 11 gra). Kohëzgjatja mesatare e intervistës ishte 33 minuta (DS = 13; diapazoni: 17 – 60). Moshë mesatare e këshilltarëve të intervistuar ishte 45 vjeç (DS = 13; diapazoni = 27 – 68). Pjesa më e madhe e këshilltarëve kishin arsim të lartë—Bachelor, Master, apo Doktoraturë—dhe jetonin në zonë urbane. Mesatarisht, këshilltarët kishin shërbyer për 15 vite në parti (DS = 10; diapazoni: 0 – 32) dhe për 2 mandate në këshill (DS = 1.71; diapazoni = 1 – 8). Pjesa më e madhe e këshilltarëve shërbenin në më shumë se një komision.